

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË - KOSOVO POLJE

Mrfaq/Bract: 127
Date/Datum: 08.11.2024

KOMUNA E FUSHË - KOSOVO POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e shtatë - VII (e jashtëzakonshme) e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 05.07.2024, ora 15:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Shpend Bardiqi, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Habib Mekolli dhe Aida Alimi.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtor e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Parayll Zogjani - Drejtor për Planifikim Urban, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë dhe Vjosa Kida Hyseni - Drejtor e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të tjera: Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhetit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Propozim për ri - destinimin e mjeteve financiare nga projektet kapitale të planifikuara për vitin 2024.
2. Propozim për lejimin e mjeteve financiare nga buxheti i komunës dhe hapjen e procedurave, për norma të reja në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin shkollorë 2024/2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të jashtëzakonshme të thirrur nga Ekzekutivi i Komunës dhe hapi diskutimin. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenime, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Propozim për ri - destinimin e mjeteve financiare nga projektet kapitale të planifikuara për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare të planifikuara me buxhet për vitin 2024 për ri - destinim nga projektet e përfunduara në një projekt tjetër', ftoi Udhëheqësen e Sektorit për Financa dhe Buxhet, që të na jap sqarime.

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E kemi propozimin për transferimin e mjeteve financiare të mbetura nga projektet kapitale, nga fondi burimor i financimit 22, të cilat duhet të barten në programin e Infrastrukturës Publike për investime, prej pesë projekteve kapitale si vijon: vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre, shuma prej: 28,385.78€, vendosja e kamerave nëpër pikat kryesore të qytetit, shuma prej: 24,123.20€, rregullimi i Sheshit në lagjen 'Dardania', shuma prej: 48,964.72€, ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndeve të lojërave, mbjellja e pemëve dekorative dhe vendosja e shportave, shuma prej: 2,471.07€ dhe shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, pastrimi gjatë sezonit dimrorë dhe verorë, shuma prej: 3,129.18€, të transferohen në programin Planifikimi hapësinor dhe rregullativ, në projektin kapital për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në shumën e mjeteve financiare prej: 107,073.95€, kjo shumë e mjeteve financiare e arrin shumën në projekte kapitale prej: 5.27%.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani ne në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas sqarimeve të dhëna për pesë projektet kapitale që kanë përfunduar, e përkrahim transferimin e mjeteve financiare të mbetura nga projektet kapitale, nga fondi burimor i financimit 22, të cilat duhet të barten në programin e Infrastrukturës Publike për investime, prej këtyre projekteve kapitale si vijon: vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre, shuma prej: 28,385.78€, vendosja e kamerave nëpër pikat kryesore të qytetit, shuma prej: 24,123.20€, rregullimi i Sheshit në lagjen 'Dardania', shuma prej: 48,964.72€, ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndeve të lojërave, mbjellja e pemëve dekorative dhe vendosja e shportave, shuma prej: 2,471.07€ dhe shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, pastrimi gjatë sezonit dimrorë dhe verorë, shuma prej: 3,129.18€, të cilat duhet të ri - destinohen dhe transferohen në programin Planifikimi hapësinor dhe rregullativ, në projektin kapital për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në shumën e mjeteve financiare prej: 107,073.95€.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne nuk jemi duke e zbatuar rregullat e praktikës së mirë parlamentare, unë nuk po e shoh këtu urgjencën e këtyre dy pikave, këto dy çështje kanë mundur të shqyrtohen në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës, para një jave, normat e arsimit dihen nga rrjedha e viteve të kaluara shkollore, ndërsa ridestinimi i mjeteve financiare të mbetura nga projektet kapitale, paraqet keqë planifikimin e parasë publike, në aspektin ligjor mund të barten vetëm shuma e mjeteve financiare prej pesë përqind e projekteve kapitale, këtu kemi projekte kapitale që barten nga viti në vitë, nuk janë realizuar as për dy vite, material i dorëzuar për shqyrtim është i mangët, në kuadër të tij përmendet neni 20, në dëshirojmë të dijmë se çka thotë ky nen, pastaj shuma që kërkohet këtu për transferimin e mjeteve financiare

është 5.27%, sipas kriterëve që definojnë me ligj, ky vendim mund të kthehet në rishqyrtim, pastaj përmenden neni 15, neni 16, pika 11, sipas mendimit tonë, këtu shihet qartë se kemi një keqë planifikim dhe keqë menaxhim të buxhetit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo mbledhje e jashtëzakonshme është e thirrur me kërkesën e Ekzekutivit të Komunës, në lidhje me këto dy pika të rendit të ditës.

Mirsad Qyqalla: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Këtu në sallën e Kuvendit të Komunës është nxehtë, nuk ka kushte për punë, kërkesa jonë për rregullimin e kushteve të punës për Ekzekutivin e Komunës dhe juve i nderuari Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, është shndërruar tani në një kërkesë të përhershme nga ana jonë, që ju nuk e përfillni, sepse këtu për tri vite dimrit është ftohtë, ndërsa tani nxehtë, pa asnjë përmirësim, nuk ka kushte as minimale për punë. Këtu pjesë e kërkesës për transferimin e mjeteve financiare nga pesë projekte kapitale të emërtuara në shkresën e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, në një projekt tjetër kapital u sqaruan nga znj. Merita Krasniqi, por ne kërkojmë të dijmë sa është vlera e këtyre projekteve kapitale që kanë përfunduar sipas përshkrimit në letër, sepse ndërtimi i Sheshit në lagjen 'Dardania' nuk është bërë për disa vite radhazi dhe bartet nga viti në vitë për shpenzim, për arsye të pengesave në teren, uzurpimeve të hapësirave publike nga subjektet afariste, të cilat ju nuk keni provuar t'i lironi asnjëherë nga fillimi deri në fund, për ta realizuar këtë projekt kapital, pastaj këtu shkruan se ka përfunduar, edhe projekti kapital për ndërtimin e këndeve të lojërave, ato nuk shihen askund në teren, këtu kemi një keqë menaxhim të buxhetit, pastaj projekti tjetër për shënjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve, po ashtu nuk shihet në teren, kjo punë është mirë vetëm në letra dhe raporte financiare, kjo punë është njësoi sikur e shënoni në letra dhe raporte të punës, tek Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që gjatë sezonit dimërorë e kemi bërë pastrimin e borës, ndërsa me ditë të tëra qytetarët kanë patur vështirësi për kalimin nëpër disa rrugë.

Hasan Ismajli: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Këtu inicuesi i mbledhjes duhet të jetë prezentë, ose dikush duhet të jetë me autorizim prej tij, në mbledhje Kryetari i Komunës nuk vjen se është injorantë ndaj Kuvendit të Komunës, ai nuk vjen përballë neve, sepse pasurimi dhe puna e tij është e jashtëligjshëm, kemi keqë menaxhim të buxhetit, vendime të jashtëligjshme, por unë nuk ndihem i injoruar prej tij. Në këtu e kemi një pikë të rendit të ditës, ku mjetet financiare kërkohet të transferohen në një projekt kapital për rrjetin e kanalizimeve, por ku janë projektet e përfunduara kapitale nga kjo listë e projekteve, nuk e kemi asnjë informacion, sa është kosto financiare e realizimit të tyre dhe ku ndodhen ato në teren, ju tani në lagjen 'Dardania' në këtë rrugë dhe disa rrugë tjera anësore jeni duke mbjellur pemë dekorative, nuk po shihen askund në teren, as këndet e lojërave për fëmijë, apo këto projekte janë të njëjta me projektet e fushave të sportit, por ju i keni votat dhe do ta bëni këtë ridestininim të mjeteve financiare. Unë propozoi që këto mjete financiare të ridestinojnë për përkrahjen e fermerëve të prekur nga breshëri para dy jave, andaj kërkoi që ta kemi një vlerësim, sa është dëmi i shkaktuar në kultura bujqësore.

Migjen Kolshi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Këtu e kemi një material për disa projekte të përfunduara nga komuna, andaj kërkohet ridestininimi i mjeteve financiare në një projekt tjetër, këtë punë e dinë shumë mirë prokurimi, sepse ata i zhvillojnë procedurat, por me projektet në fshatin Harilaç është tepruar, pritët të investohen 1.7 milion euro në rrjetin e kanalizimit dhe këtu nuk hyn fshati Harilaç, i cili ka shumë nevojë për rregullimin e ujësjellësit, kërkesa ime është që për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit për sigurimin e ujit të pijes në fshatin tonë, të ndahet shuma

e mjeteve financiare prej katër qind mijë euro, por po shihet se ky Ekzekutiv i Komunës, është duke e anashkaluar fshatin Harilaç sa i përket investimeve publike në disa projekte kapitale.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Arsyeja për thirrjen e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme, është sepse me datën 1 shtator fillon mësimi dhe ne duhet t'i kemi mësuesit në klasë, shumë mirë e dini se procedurat e rekrutimit marrin shumë kohë, është edhe koha e ankesave, mësimdhënësit e ri duhet ta kenë një kontratë të punës. Lidhur me transferimin e mjeteve financiare, propozimi është shumë konkret, këto mjete financiare janë kursyer nga projektet kapitale të përfunduara dhe procedurat ligjore e kërkojnë, që për shpenzimin e tyre ato duhet të ridestinohen dhe transferohen në projekte tjera publike, kërkesa jonë është që këto mjete financiare të mos shkojnë në suficit. Mjetet financiare të planifikuara për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit janë të pamjaftueshme, andaj duhet të rriten mjetet financiare në këtë kod të projektit kapital, pjesën procedural dhe administrative e sqaroi Udhëheqësja e Sektorit për Financa dhe Buxhet.

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: Tani unë dua të ju sqaroi shumat e mjeteve financiare të shpenzuara dhe të mbetura. Kontrata për vendosjen e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tij, është në shumën e mjeteve financiare prej: 62,000.00€, ndërsa mjete financiare të zotuar janë: 28,000.00€, bartja është bërë me vendim të Kuvendit të Komunës, është automatike, sepse Kuvendi ka bërë bartjen e mjeteve të lira financiare, të cilat kanë qenë të kontraktuara, këtu përfundon transferimi i buxhetit, i cili duhet të bëhet, sepse kontrata e planifikuar është realizuar, kontrata për projektin vendosja e kamerave nëpër pikat kryesore të qytetit është në shumën e mjeteve financiare prej: 691,000.00€, ndërsa mjete financiare të zotuar janë: 24,000.20€, kontrata për projektin ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndeve të lojërave, mbjellja e pemëve dekorative dhe vendosja e shportave është në shumën e mjeteve financiare prej: 54,000.00€, ndërsa mjete financiare të zotuar janë: 2,000.00€ dhe kontrata për projektin shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, pastrimi gjatë sezonit dimrorë dhe verorë, është në shumën e mjeteve financiare prej: 58,000.00€, ndërsa mjete financiare të zotuar janë: 3,000.00€. tani për kontratën për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve fshat qytet e kemi shumën prej: 856,000.00€, të cilës propozojmë që t'i transferohen edhe 107,000.00€.

Hasan Ismajli: Ne kërkojmë sqarime për këndet e lojrave, ku gjinden ato në teren, në qytet nuk ka, ne i kemi parë këto kënde të lojërave në fshatrat: Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm, disa ulëse në Parkun e Pishave në fshatin Sllatinë e Vogël. Investimi publik në sheshin e lagjes 'Dardania' në Fushë-Kosovë, aty nuk ka sheshë, tani keni filluar me mbjelljen e drunjëve dekorativ, si zëvendësim për sheshin e qytetit në këtë rrugë dhe në rrugët anësore jashtë planifikimit, pastaj pastrimi i rrugëve gjatë sezonit dimërorë dhe verorë, vetëm njëherë është parë cisterna në rrugën e Dardanisë, pastaj në vitin 2023, nuk ka patur të reshura të borës fare.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu u tha nga Nënkryetari i Komunës, se planifikimi i procesit mësimorë kërkon kohë, kjo tregon sa të dobët jeni ju në fushën e arsimit, kur nuk e keni të qartë asnjëherë mënyrën e fillimit të vitit të ri shkollorë, nuk e dini sa mësues ju duhen në shkolla, keni ngecje lidhur me normat në arsim, lidhur me pagesat e mësimdhënësve, së paku në këtë fushë duhet të jeni auto kritikë vetë dhe të filloni, me një punë serioze për përmirësimin e gjendjes faktike. Si ka qenë e mundur që këtë punë nuk e keni ditur me datën 27 qershor, ndërsa e keni dituar dhe të njohur sipas juve me datën 2 korrik. Po thuani se kanë mbetur mjete financiare të pa shpenzuara, nga kontrata për vendosjen e ndriçimit publikë, ndërsa ai për dy

vjet nuk është funksional fare, vendosja e kamerave në qytet, nuk është kryerë si projekt publikë ende, shënjëzimi i rrugëve, këtu punët janë keqë, gropat në rrugë janë të ngjyrosuara, ky është fakt, që shihet nga secili qytetarë.

Nënkryetari i Komunës: Unë nuk jam këtu për të lexuar mendjet e juaja politike, ku ndoshta mund të jetë edhe politika e juaj për të fituar sa më shumë vota, por ju duhet ta dini se kalendari në arsim, nuk është i njëjtë me vitin buxhetorë, normat për mësues ndahen nga Qeveria, është e vërtetë se neve na janë dhënë norma shtesë në buxhetin e vitit 2023, për këtë punë jemi shumë falënderues Qeverisë së Kosovës, por nevojat në komunën tonë janë të mëdha, sepse mësuesit janë në komuna tjera të vendit tonë, ku numri i nxënësve është shumë më i vogël se në komunën tonë, andaj ne jemi të detyruar që të marrim vendime të tilla në Kuvendin e Komunës nga burime tona të financimit dhe programet buxhetore, për të siguruar mësimdhënës për nxënësit, sepse nxënësi duhet ta ketë mësuesin në klasë me datën 1 shtator.

Vlonjat Hasani: Numri i mësimdhënësve që shkojnë në pension dihet dhe deri dikun pushimet e lehonisë mund të dihen nga vitet paraprake, por këtu kemi të bëjmë me një planifikim të dobët.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për ri - destinimin dhe transferimin e mjeteve financiare nga pesë projektet kapitale të planifikuara dhe emërtuara për vitin 2024, për shpenzim në projektin kapital për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në fshatra dhe qytet'.

U votua me: katërbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe pesë abstenime, gjithsej nëntëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ri - destinimin dhe transferimin e mjeteve financiare nga pesë projektet kapitale të planifikuara dhe emërtuara për vitin 2024, për shpenzim në projektin kapital për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në fshatra dhe qytet' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 902, të datës 02.07.2024 për transferimin e mjeteve financiare të mbetura, si të pa shpenzuara nga projektet kapitale të përfunduara, prej burimit të financimit 22, nga nën - programet e Infrastrukturës Publike 18162, nga pesë projekte kapitale, në projektin kapital të evidentuar në paragrafin Nr. 2 nën - programin e Planifikimit Hapësinorë dhe Rregullativ 66015, të këtij vendimi sipas përshkrimit në vijim:
 - 1.1 Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre, kodi i projektit 44697, shuma e mjeteve financiare prej: 28,385.78€;
 - 1.2 Vendosja e kamerave nëpër pikat kryesore të qytetit, kodi i projektit 44715, shuma e mjeteve financiare prej: 24,123.20€;
 - 1.3 Rregullimi i Sheshit në lagjen 'Dardania', kodi i projektit 49363, shuma e mjeteve financiare prej: 48,964.72€;
 - 1.4 Ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndeve të lojërave, mbjellja e pemëve dekorative dhe vendosja e shportave, kodi i projektit 52489, shuma e mjeteve financiare prej: 2,471.07€ dhe
 - 1.5 Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, pastrimi gjatë sezonit dimëror dhe veror, kodi i projektit 52490, shuma e mjeteve financiare prej: 3,129.18€.
2. Mjetet financiare të evidentuara në paragrafin një, nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, transferohen për shpenzim në nën - programin e Planifikimit Hapësinorë dhe

Rregullativ 66015, në projektin kapital: Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit - fshatra, qytet, kod i projektit 49732, në shumën e përgjithshme të përmbledhur të mjeteve financiare prej: 107,073.95€.

Pika e dytë (2) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare nga buxheti i komunës dhe hapjen e procedurave, për norma të reja në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin shkollorë 2024-2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare nga buxheti i komunës dhe hapjen e procedurave, për norma të reja në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin shkollorë 2024-2025', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për vitin e ri shkollorë 2024-2025 në Komunën e Fushë-Kosovës na duhen edhe 66 norma të reja në arsim, andaj për periudhën katër mujore të këtij viti na nevojitet shuma e mjeteve financiare prej: 159,456.00€, ju të gjithë e dini se granti specifik i arsimit financohet nga Qeveria e Kosovës, ne i kemi një mijë nxënës në klasat e parë, andaj na duhen shumica e mësuesve për ciklin e ulët. Në shtator pritet të përfundon edhe ndërtimi i Institucionit Edukativo Arsimore i financuar nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe objekti i ri shkollorë i financuar nga komuna jonë, po ashtu ligjërisht ne jemi të obliguar që ta dërgojmë mësuesin në klasë për nxënës, andaj na nevojiten 30 mësues për arsimin fillor dhe të mesëm, pastaj 5 mësues për arsimin e mesëm të lartë, pastaj 10 edukatore për parafillore dhe mësues për persona me nevoja të veçanta, ku numri i këtyre nxënësve në komunën tonë tani është shumë i lartë, janë gjithsej 70 fëmijë, që kanë nevojë për këta asistentë, andaj kjo është një ndër sfidat tona, që ne jemi marrë shumë si Drejtori Komunale e Arsimit dhe kemi bërë disa zgjidhje, por kjo punë don financim për ta eliminuar dhe zgjidhur si çështje në periudhën e ardhshme. Po ashtu kemi shumë nevojë për pedagog dhe psikolog në shkolla, ku planifikojmë të kemi 4 përkatësisht pesë, pjesa tjetër janë stafi administrative dhe mbështetës. U tha këtu nga disa kolegë të Kuvendit se kemi mos planifikim të duhur, kjo nuk qëndron, sepse ne kemi një rritje të numrit të nxënësve brenda një viti nga 1300 deri në 1400 nxënës të ri dhe mësuesit e ri duhet të paguhen nga burimet tona të financimit, që e rëndojnë buxhetin e komunës, sepse nuk kemi norma në arsim, aq sa na duhen për mbarëvajtjen e rregullt të procesit edukativo-arsimorë. Nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, për parashkollorët në fshatin Harilaç, se do ta shqyrtojmë edhe kërkesën e banorëve të fshatit Harilaç.

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e normave të reja në arsim dhe kërkojmë që të fillohet me procedurat e rekrutimit të mësuesve të ri, ku e kemi sipas të dhënave në këtë propozim një planifikim të detajizuar për shkolla dhe çerdhe, në mënyrë që në shtator ta kemi një fillim të mbarë të vitit të ri shkollorë. Ne të gjithë e njohim faktin se kemi rritje enorme të numrit të nxënësve, kemi shumë nevojë edhe për psikolog në shkolla, po ashtu nevojitet edhe mendimi profesional i logopedit në shumë raste në shkollat tona, ne duhet ta kuptojmë, se këtu si Legjislativ i Komunës, e kemi obligim ligjor që të krijojmë kushte sa ma të mira për procesin mësimorë, ta ndajmë buxhetin e nevojshëm për shkolla, ndërsa është puna e Ekzekutivit të Komunës realizimi i projekteve të renovimit dhe rekrutimi i mësimitdhënësve.

Durim Hajra: Unë nuk pajtohem me konstatimin e Nënkyetarit të Komunës, se ne po bëjmë politikë këtu, as me mendimin e Drejtorit të Arsimit që theksoi, se ju nuk i njohni gjërat në arsim, planifikimi në arsim bëhet në bazë të trendit të dy viteve të fundit, tani jemi në korrik, ju e dini që në shtator do të jenë tre qind nxënës më shumë, andaj duhet të kemi masa për zgjidhje të mbështetura në planifikim paraprakë. Ne nuk jemi këtu për të bërë politikë me arsimin, sepse edhe ne i kemi fëmijët në shkollë, ju po e theksoni se kemi përcjellur shkresa në Ministrinë e Arsimit, por ju nuk mund ta bartni fajin askund, sepse përgjegjës për arsimin fillor dhe të mesëm është komuna, dihet modeli për caktimin e normave në arsim, dihen kompetencat që i kanë Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave, ne këto probleme i kemi me vite, në vazhdimësi, këto nuk u zgjidhen as me dhënien e normave të reja në vitin 2023, të cilat janë dhënë për arsim, ndërsa nga ju janë lëvizuar edhe në kategori tjera dhe në shërbime administrative.

Mirsad Qyqalla: Në fillim dua të ndërlihem me diskutimin e Drejtorit të Arsimit, këtu kolegët thanë se ka keqë planifikim, kjo punë e ka gjenezën dikun, thelbi është te dhënia e lejeve ndërtimore, të cilat nuk janë përcjellur me planifikim të duhur për sistemin e arsimit. Çështja e nxënësve është e ndishme, ne në qytet jemi keqë, numri i nxënësve në klasa është i madh, janë edhe mbi dyzet nxënës në një klasë, nuk ka mundësi të zhvillohet sa duhet programi mësimorë me këtë numër në asnjë klasë të tillë, nga mësimdhënësit tonë, obligimi ligjor për arsim nga komuna është këtu pajtohem, por këtu duhet ta kemi një debat të thellë për ta gjetur një zgjidhje, qoftë edhe të përkohshme, për aq sa kemi mundësi ta ndryshojmë, kjo është brenga jonë, ne kemi ndarë buxhet për norma edhe në muajin janar, ku buxhet tani është vetëm për katër muaj, si do të veprojmë në muajin janar, meqë buxheti afërsisht është i njëjtë. Fluksi i ardhjes së nxënësve të ri, duhet të përcjellet me infrastrukturë shkollore, me krijimin e kushteve sa më të mira për mësim, pyetja ime këtu është, kush na garanton neve se ku vendim, nuk do të kthehet në rishqyrtim, sikur vendimi paraprakë për norma në arsim.

Hasan Ismajli: Diskutimi i Nënkyetarit të Komunës është puro politikë këtu në Kuvend, kërkohen 66 norma të reja në arsim, unë do ta votoi këtë propozim, sepse nxënësit duhet ta kenë mësuesin, ata janë fëmijë, nuk janë fajtor për gjendjen faktike në komunën tonë, këtu unë dalë jashtë petkut tim të opozitarit, ndërsa ju merrni mjetet financiare ku të doni, është çështje e juaja. Por ju keni shpallur konkurs edhe për drejtor të shkollës dhe çerdhes, që ende nuk janë në funksion, apo shkollën e re nuk mund ta emërtoni prapë, sepse nuk i plotëson kushtet ligjore, do ta quani Aneks III i shkollës 'Mihal Grameno' dhe do ta dërgoni atje një Zëvendës Drejtor, sikur edhe në dy Anekset tjera. Po ashtu pagesa e këtyre mësimdhënëseve, sipas planifikimit tuaj me një propozim është vetëm për katër muaj, si do të veprohet tutje, tani as ju nuk e keni të qartë këtë punë, mësimdhënësit do të punojnë pa paga për një kohë të gjatë.

Migjen Kolshi: Qëndrimin e subjektit politikë e dha kolegu jonë z. Mirsad Qyqalla, me normat në arsim këtu është keqë përdorur edhe më herët, kanë qenë dy norma në arsim që janë bartur në Administratën Komonale dhe njerëzit janë punësuar në Drejtorinë e Planifikimit Urban, unë e kuptoi se nevojiten edhe 30 norma të reja në arsimin fillor dhe të mesëm, por këta mësues nuk do të mund të hyn në listën e pagave, ka raste kur hyn në listën e pagave nëse jeni e afërtë me zyrtarë në komunë, këto raste kanë ndodhur, në muajin mars një punëto e arsimit ka hyrë në listën e pagave me mbiemrin Jashanica, pyetja ime këtu është për Nënkyetarin e Komunës dhe Drejtorin e Arsimit, sa kohë do të mbesin këta mësimdhënës jashtë listës së pagave.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Granti qeveritarë kur do të ndahet sipas regjistrimit të ri popullsisë, a keni ndonjë informatë, kur do të jipen rezultatet e regjistrimit të popullsisë, po ashtu duam ta dijmë nga vijën shumica e nxënësve të ri në shkollat tona, sepse shërbimet në arsim ne jemi të obliguar t'i japim fillimisht për banorët tonë, kurse me ardhjen e pollullsisë nga viset tjera, neve po na krijohen probleme të mëdha, meqë arsimi fillor dhe i mesëm është në kompetencën e komunës sipas ligjeve në fuqi.

Drejtori për Arsim: Numri i nxënësve në një klasë sipas rregullave standarde duhet të jetë 22.5 nxënës, ndërsa ne i kemi nga 35 nxënës në një klasë. Konkursat janë publike për secilën lëndë, numri i aplikimeve sidomos për mësimdhënës të ciklit të ulët, është relativisht i madh, hyrja në listën e pagave bëhet në baza mujore, me datën dhjetë të secilit muaj bëhen ndryshimet, nëse ka ndonjë vend të lirë në listën e pagave në programin e caktuar me buxhet, për vendosjen e nxënësve në shkollën e caktuar, kjo bëhet sipas ndarjes zonale me vendbanim për rrugë të caktuara në zonën urbane.

Hasan Ismajli: Ka disa nxënës që vendbanimin e kanë në pjesën ku janë ndërtesat e Kompanisë 'Al Trade', ku qindra nxënës duhet të jenë në shkollën Aneks 2, familjet e bëjnë një kontratë te noteri dhe shkojnë në zonën e caktuar të qytetit, ju kur e keni ndërtuar këtë shkollë keni thënë, se kjo shkollë do të jetë e pavarur, por nuk janë plotësuar kushtet ligjore për emërtimin e shkollës së re.

Vlonjat Hasani: Tani problemi është edhe të nxënësit e klasëve të para, p.sh në fshatin Miradi e Epërme, janë regjistruar nxënësit në klasën për parashkollorë, këta nxënës janë më të përgatitur për fillimin e klasës së parë, ndërsa në zonën urbane të qytetit fëmijët nuk e kanë këtë mundësi, pyetja ime është kur mund të presim, që të fillojmë me parashkollorë në qytetin e Fushë-Kosovës. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare nga buxheti i komunës dhe hapjen e procedurave, për norma të reja në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin shkollorë 2024-2025'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishmit në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare nga buxheti i komunës dhe hapjen e procedurave, për norma të reja në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin shkollorë 2024-2025' dhe mori:


V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1341, të datës 02.07.2024, për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 159,456.00€ dhe fillimin e hapjes së procedurave për gjashtëdhjetë e gjashtë (66) norma për vende të reja të punës në arsim, për periudhën kohore shtator/dhjetor 2024, të vitit shkollorë 2024/2025, nga granti specifik i arsimit me kod buxhetor Nr. 920, si vijon:
 - 1.1 Për 30 norma të reja për mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët;
 - 1.2 Për 1 normë për një drejtor shkolle;
 - 1.3 Për 1 normë për një drejtor të institucionit parashkollorë;
 - 1.4 Për 5 norma të reja për mësimdhënës për arsimin e mesëm të lartë;
 - 1.5 Për 10 norma të reja për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta;
 - 1.6 Për 10 norma të reja për edukatore për para fillorë;
 - 1.7 Për 4 norma të reja për pedagog dhe


- 1.8 Për 5 norma të reja për psikolog.
2. Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të lejuara nga buxheti i komunës, e cekur në pikën një të vendimit, do të shfrytëzohen për pagesat e gjashtëdhjetë e gjashtë (66) normave të reja për mësimdhënës dhe personel administrativ, për periudhën shtator/dhjetor të vitit shkollorë 2024/2025, sipas specifikacionit dhe llogarisë tabelare të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimin e mjeteve financiare nga pika një e këtij vendimi, nga granti specifik i arsimit me kod buxhetor Nr. 920, do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në orën 16:45 minuta.**

**Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e tetë - VIII të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.07.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi, Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Habib Mekolli, Shpend Bardiqi, Vlonjat Hasani, Dardane Sogojeva Shala, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Doruntina Jashari.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Parayll Zogjani - Drejtor për Planifikim Urban, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë dhe Ekrem Berjani-Drejtor për Zhvillim Ekonomik, Ardit Sekiraqa - Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis.

Të tjerë: Drejtori i Qendrës për Punë Sociale - Abaz Xhigoli dhe Ejup Qyqalla - Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 30.05.2024, 27.06.2024 dhe 05.07.2024.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e planit vjetor të punës në gjashtëmujorin e parë.
4. Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt - dokumentit për vlerësimin e rrezeve natyrore dhe rrezeve tjera për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
5. Shqyrtimi i kërkesës me Nr. 02-070/05-0021913/24 për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës.
6. Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoj që të hyn si pikë shtesë e rendit të ditës ‘Ndryshim -plotësimi i vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021’.

Hasan Ismaili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Meqenëse ka pak pika të rendit të ditës, kisha propozuar një pikë shtesë të rendit të ditës, e cila për mua dhe qytetarët është shumë imediate, që Kuvendi të merr një vendim që brenda një afati të caktuar ta bënë lirimin e uzurpimit të hapësirave publike dhe publiko-private, sidomos të bizneseve të cilat i kanë zënë hapësirat e parkingut duke e zgjeruar lokalin me pjesën e terasës, mirëpo kohën e fundit kemi dukuri të cilat kanë filluar ende me i vazhduar deri në trotuare, kërkoj nga të gjithë kolegët që të hyn si pikë shtesë e rendit të ditës ‘Lirimi i uzurpimit të hapësirave publike dhe publiko-private’.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar, më lejoni që ta lexoj nenin 20 të ‘Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës’. Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkoj shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike. Unë mendoj se dy propozimet kanë të bëjnë me rëndësinë publike, sepse pika shtesë e cila u propozua nga Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete z. Bashkim Krasniqi ‘Ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021’, është çështje rutinore, ndërsa pikën të cilën e propozoj anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli është çështje më shumë e Ekzekutivit, sesa e Kuvendit. Mendoj se Ekzekutivi duhet me u merr me këtë çështje dhe nuk ka nevojë me nxjerr Kuvendi vendim, janë ligjet dhe rregulloret të cilat Ekzekutivi duhet t’i zbatoj. Sa i përket propozimit të pikës së parë unë nuk kam asnjë kërkesë nga ana e juaj dhe për mua nuk është urgjente, sepse ke pritur që sa muaj mund të presësh deri në mbledhjen tjetër, të hyjë si pikë e rregullt e rendit të ditës. Ndërsa sa i përket pikës së dytë, i nderuar sjelle me shkrim dhe në mbledhjen e radhës hyn si pikë e rregullt e rendit të ditës. Ky është qëndrimi im si Kryesues i Kuvendit të Komunës, po ashtu është qëndrimi i Shefave të Grupeve Parlamentare të cilin e kemi marrë në Kuvend, me të cilin jemi dakorduar që qoftë Ekzekutivi qoftë ne si asambleistë ditën e mbledhjes mos me sjellë pika shtesë të rendit të ditës, nëse nuk janë urgjente. Mirëpo, unë po i dëgjoj edhe qëndrimet e Shefave të Grupeve Parlamentare për këto dy propozime. Po ashtu sqaroi se ekstrakti i procesverbalit të datës 05.07.2024, nuk është përgatitur dhe do ta aprovojmë në mbledhjen e ardhshme.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishmit në mbledhje. Sa i përket rendit të ditës ne jemi për këtë rend dite, ndërsa sa i përket pikave shtesë duhet ta kemi parasysh edhe natyrën e pikave të cilat kanë ardhur në Kuvend. Unë mendoj që sa i përket pikës për ‘Ndryshim -plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021’, kjo është çështje procedurale, ku edhe në të kaluarën kemi bërë ndryshime të tilla. Ndërsa sa i përket pikës së z. Hasan Ismajlit mendoj se kjo është në domenin e Drejtorisë së Inspektoratit dhe ne nuk mundemi me marrë vendime për lirimin e uzurpimit të hapësirave publike dhe publiko-private, sepse përgjegjëse për këtë çështje është Drejtoria e Inspektoratit. Ne jemi për me përkrah rendin e ditës në tërësi, përfshirë edhe pikën e propozuar nga Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete z. Bashkim Krasniqi.

Durim Hajra: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, i mbështet të dy propozimet, mirëpo pak është shqetësuese si parafolësi i ndau këto dy pika, nëse të dy pikat janë në rregull dhe s’ke diçka kundër është mirë të dy propozimet me i mbështet ose me i hedh poshtë. Çka është interesante që partnerit të koalicionit s’keni qenë në gjendje që dy muaj me i’a sjellë si pikë të rendit të ditës kërkesën të cilën e ka adresuar, ku kjo kërkesë është vetëm çështje procedurale, kjo tregon shumë, kështu që mos pritni prej opozitës. Sa i përket pikës së dytë i nderuar Kryesues unë mendoj, jo që është

urgjente, por është shumë urgjente. Nëse dikush e sheh që kjo çështje mundet me u përjashtuar nga diskutimi me nenin 20 të Rregullores së Kuvendit, unë mendoj se është gabim, kjo mundet me u diskutuar edhe tek pika e fundit, në të ndryshme. Propozim me shkrim, besoj se nuk ka nevojë, sepse po të tregon gjendja faktike në teren dhe uzurpimi është duke vazhduar çdo ditë e më shumë sidomos në lagjen 'Dardania' në qytet. Në parim jemi me i mbështet këto dy pika, mirëpo po i ndjekim disa praktika të mira parlamentare.

Mirsad Qyqalla: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Unë i dëgjova dy versionet e Shefave të Grupeve Parlamentare, unë bisedova edhe me z. Bashkimin sa i përket pikës shtesë dhe kjo pikë mendoj se është vetëm çështje procedurale. Ndërsa sa i përket pikës së kolegut tonë z. Hasan Ismajli kjo është dashtë me u debatua gjatë. Unë jam i atakuar pikërisht me këtë pikë dhe e kam një mal me ankesa, me vërejtje për mos punë. Unë pajtohem me kolegun z. Durim Hajra që kjo është në interes të përgjithshëm dhe është gjendje alarmante pikërisht në lagjen 'Dardania'. Unë kisha propozuar që të hyjë si pikë shtesë, të kemi material dhe ta dimë saktë cila është kërkesa juaj?

Hasan Ismaili: Faleminderit Kryesues. Në fakt unë e di nenin 20 të Rregullores së Kuvendit, mirëpo këto vite që jam këtu dy ose tre herë kam bërë kërkesë Kryetarit dhe Nënkrjetarit të Komunës, po ashtu kam komunikuar me mesazhe me Nënkrjetarin e Komunës për këtë pikë e cila është shumë e rëndësishme dhe kërkesa ime është gjuajtur në shportë, ku e cila as në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk ka shkuar. Këtë kërkesë e kam këtu përpara, është një prej objekteve që është ndërtuar në pronë të komunës, kam shkruar edhe mesazhe përmes telefonit me Nënkrjetarin e Komunës, të njëjtën kërkesë i'a kam dërguar edhe Drejtorit të Inspektoratit, i cili ka disa muaj që nuk merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit. Lejet të cilat i ka lëshuar Drejtoria e Inspektoratit duhet t'i revokojë, sepse nuk ka të drejtë me lëshuar leje, sidomos në prona publiko-private, ku ajo hapësirë është e të gjithë banorëve dhe nuk ka asnjë nënshkrim prej tyre që kanë të drejtë ta bëjnë uzurpimin e pronave publiko-private. Ju i nderuar Kryesues dhe Nënkrjetar nuk jetoni në Fushë-Kosovë dhe nuk atakoheni me problemet e përditshme që ne dhe qytetarët tjerë i kemi, qëllimi im ka qenë me sjellë në votim këtë pikë dhe ta shohim, se kush është për dhe kush është kundër. Nëse kishte kaluar kjo pikë, propozimi im ka qenë nga ne asambleistët, kush kemi uzurpuar këtu, sepse njëri nga uzurpatorët është Ish/Shefi i Grupit Parlamentarë që ka qenë më herët. Propozimi im është ta qesim në votim dhe ta shohim, kush është për dhe kush është kundër propozimit, që unë e kam sjellë sot.

Nënkrjetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, unë komunikoj me të gjithë me mesazhe me këshilltar komunal, qytetarë të cilët kanë kërkesa të ndryshme dhe trajtojnë çështje të ndryshme. Një prej tyre ka qenë edhe kjo nga z. Hasan Ismajli. Ju mund ta vendosni këtë pikë me shumicë të votave, mirëpo unë kam një propozim që nëse e lëmë për mbledhjen e radhës, që të vijë si pikë e rregullt e rendit të ditës, në mënyrë që ta trajtoni një temë kaq të rëndësishme që është kjo. Mirëpo ju vendosni dhe ne jemi për me dëgjuar dhe me diskutuar, qoftë sot, qoftë në mbledhjen e radhës.

Laureat Gojnovci: Unë u akuzova nga disa kolegë, arsyeja pse nuk e përkrahëm është, sepse nuk jemi autoriteti në Kuvendin Komunal që të marrim vendim për lirim dhe hapësirave publike. Në të kaluarën kemi pasur një pikë të rendit të ditës e cila ka qenë 'Informatë e Drejtorisë së Inspektoratit' dhe unë pajtohem me Nënkrjetarin e Komunës që në mbledhjen e radhës të vijë si informatë dhe atëherë mundemi me pas diskutim më kualitativ, për shkak se jemi të gjithë të përgatitur për pikën e rendit të ditës, ndërsa pse nuk duhet krahasuar kjo pikë me pikën e Bashkimit, është për arsye, se kjo pikë është vetëm procedurale.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës me dy pika të propozuara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës pikat për

‘Zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet’ dhe ‘Lirimin e uzurpimit të hapësirave publike dhe publiko-private’. Pas qartësimeve lidhur me procedurat, e qes në votim ‘Propozimin për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete, me përfaqësuesin tjetër egjiptian’.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota ‘për’, katër votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Propozimi për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete, me përfaqësuesin tjetër egjiptian’, kalon për shqyrtim.

Tani e qes në votim ‘Lirimin e uzurpimit të hapësirave publike dhe publiko-private’.

U votua me: njëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, njëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Lirimi i uzurpimit të hapësirave publike dhe publiko-private’, nuk hyn si pikë e rendit të ditës në shqyrtim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës me pikën shtesë e cila u votua.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, pesë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenime, gjithsej njëzet pjesëmarrës në votim nga të pranishmit në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës me pikën shtesë në mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 30.05.2024 dhe 27.06.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe aprovim ‘Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 30.05.2024, 27.06.2024. Ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të japin vërejtjet apo sugjerimet e tyre.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam disa vërejtje për ekstraktin e procesverbalit, kërkoi që këto të përmirësohen para nënshkrimit dhe publikimit të tij, vërejtjet e mia janë në ekstraktin e muajit maj në faqen 6, tek diskutimi im kur unë kam bërë propozim nga foltorja kur ka qenë auditori dhe kam kërkuar nga ai që të auditojë komplet listën e subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këtu po shkruan që unë kam biseduar me të jashtë mbledhjes, ndërsa unë ju kam drejtuar prej foltores dhe nuk është e vërtetë që unë kam biseduar me të. Ndërsa tek faqja 9 tek lagjja ‘Eliza C’, i kam bërë pyetje Drejtorit të Planifikimit Urban, a kanë këto ndërtesa pranim teknik? Këtu thotë se leja u lëshua sipas hartës zonale, ndërsa kjo leje është lëshuar në vitin 2018, ndërsa harta zonale është aprovuar në shtator të vitit 2020 dhe nuk qëndron kjo, sepse pyetja ime ka qenë vetëm, a ka pranim teknik? Interesi im që kam parashtruar këtë pyetje është se në ‘Elizën C’, sipas një aneks - marrëveshje që është bërë jashtëligjshëm mes Kryetarit të Komunës dhe Kompanisë në fjalë Komuna e Fushë-Kosovës, i lejon atij mbindërtim dhe për kompensim i merr 1.000 metra katror dhe një lokal prej 400 metra katror, për këtë më ka interesuar, a është bërë pranimi teknik dhe ai lokal, a ka dal pronë e komunës apo e kujt është si pronë? Ndërsa tek procesverbali i muajit qershor kam vërejtje në faqen 9, ku e kam pasur një debat me Nënkryetarin e Komunës, ku unë kam thënë që banorët e tri Komunave: Medvegjë, Preshevë dhe Bujanoc, janë diskriminuar duke mos u informuar për regjistrim të popullsisë dhe Nënkryetari i Komunës ka dalë në foltore dhe ka thënë, nuk i kemi diskriminuar, në të kundërtën ne i kemi avansuar, sepse i kemi punësuar në arsim pa dokumentacione dhe unë s’kam mundur me u bind, që dikush mundet me u punësuar pa dokumentacione në arsim, andaj kërkoi që diskutimi im të përmirësohet.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne nuk marrim pjesë në aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve, për derisa nuk bëhet publikimi i audio - incizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mirsad Qyqalla: Nuk e mohoj që Sekretari i Kuvendit z. Hasani është i ngarkuar, mirëpo ne gjithmonë po kemi vonesë të materialit. Sa i përket ekstrakteve të procesverbaleve kishte qenë mirë me u munduar me përpiluar më mirë, sepse me të vërtetë nganjëherë janë gjërat e pakuptimta. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i qiti në votim për aprovim 'Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më datën 30.05.2024 dhe 27.06.2024', me përmirësimin e diskutimit të kolegut z. Hasan Ismajli.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave i aprovoi 'Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datën 30.05.2024 dhe 27.06.2024', me përmirësimin e diskutimit të kolegut z. Hasan Ismajli.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të paraqesin pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Pyetjet e para i kam për Drejtorinë e Arsimit, por meqenëse Drejtori i Arsimit nuk qenka po i drejtohem Nënkrjetarit të Komunës. I nderuar Nënkrjetar i Komunës besoj që çështjet dhe problematikat i diskutoni edhe me Drejtorët e Drejtorive, edhe me stafin tjetër të fushës. Pak më herët u diskutua për çështjen e uzurpimit të pronave publike, e që pyetja e parë ka të bëjë pikërisht me një pronë publike, e cila realisht u dashur me qenë e fundit në atë listë që keqpërdoret dhe uzurpohet konkretisht me oborin e shkollës 'Mihal Grameno'. Unë nuk e di kush është ai drejtor ose ai zyrtarë që jep leje, që oborri i shkollës me ju dhanë në shfrytëzim një operatori privat, kjo është e çuditshme, qoftë kjo edhe kundër një pagese e cila për Komunën e Fushë-Kosovës nuk ka ndonjë interes. Unë sot deshta të përballem me Drejtorin e Arsimit, i cili në një prononcim publik tha, se unë nuk kam informata dhe nuk kam dhënë pëlqim me u dhënë në shfrytëzim oborri i shkollës 'Mihal Grameno'. Nëse një Drejtor nuk e din çka ndodh me oborret e shkollave dhe me shkolla, atëherë kjo lë shumë për të dyshuar, se sa është në gjendje të administrojë me çështjet tjera. Pyetja e dytë ka të bëjë me sigurinë e nxënësve tek shkolla 'Mihal Grameno' dhe tek shumë shkolla tjera, ku në vazhdimësi këtë e adresojnë si shqetësim, ku tek shkolla 'Mihal Grameno' ka pas edhe aksidente me fatalitet vitin e fundit, e që ne e kemi ngritë edhe si shqetësim në mbledhje të Kuvendit, por edhe prindërit nëpërmjet formave të tjera dhe nuk është ndërmarrë asgjë deri tash. Nënkrjetar po të drejtohem tash ty që të merresh me sigurinë e nxënësve nëpër shkolla. Drejtori i Inspektoratit, nuk është duke ardhur në mbledhje dhe problematikat kryesore janë këtu. Unë dua ta ngrisë një çështje për një zonë të caktuar, e që është lagjja 'Dardania' ku unë edhe jetoj në këtë pjesë. Brenda dy muajve janë të uzurpuara mbi njëzet e pesë parkingje të cilat janë në prona të përbashkëta, realisht që janë të destinuara për banorë, janë të uzurpuara prej kafiterive e marketeve të ndryshme, unë i kam të identifikuar edhe cilët operatorë ekonomik, e kanë bërë uzurpimin e tyre. Po e ri përsëris një çështje, të cilën e kanë ngrit edhe shumë kolegë të tjerë, e që nuk është duke u ndërmarrë asgjë, që ka të bëjë me ndërtesat kolektive tek Stadiumi i Qytetit, qe kanë probleme jo vetëm me lokalet prej zhurmave, por edhe prej dukurive tjera negative. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike po i bëj disa pyetje. Ndrichiimi publik mesa di një kompani tjetër e ka fituar kontratën kornizë për mirëmbajtje, ka filluar puna në qytet, mirëpo në rrugën 'Regjep

Mala' nuk funksionon ndriçimi publik po ashtu edhe në fshatin 'Harilaç' ka probleme. Po ashtu në rrugën 'Regjep Mala' besoj se e keni parë me rastin e reshjeve të fundit atmosferike, që ajo rrugë bllokohet për këmbësorë, për shkak se nuk ka rrjet kanalizimit as fekal e as atmosferik. Kjo është në domenin e drejtorisë suaj dhe presim që të ndërmerrni masa. Pyetjen që e kam bërë edhe në mbledhjet e kaluara çka është duke ndodh me projektin e drunjëve dekorativ, nëse e ka ndërprerë operatori mbjelljen e tyre dhe nuk e pengon asgjë, me i mbyllë ato mbulojat që janë në paramasë dhe para llogari, të cilat nuk i kanë mbyllë asnjë deri tash. Në pjesën e qytetit mungojnë kapakët e pusetave, javën e kaluar një qytetare e shtyrë në moshë u lëndua për shkak të mungesës së pusetës. Për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është një objekt në 'Miradi të Poshtme', objekti i xhamisë së vjetër, sa unë mora informacion është i vjetër si objekt dhe dita ditës është duke u rrënuar dhe pyetja konkrete është, a keni paraparë diçka me e ruajtur këtë objekt? Pasi që shumë lehtë mundet me qenë objekt i trashëgimisë kulturore, nëse veq e ka atë vjetërsi qysh po e prezantojnë banorët aty. Po ashtu kam edhe një pyetje ku në atë kohë nuk keni qenë drejtor, në vitin 2021 në fshatin 'Harilaç' ka qenë duke u ndërtuar një fushë, në mbledhjen e kaluar e ka përmendur edhe kolegu, ka filluar mu ndërtuar fusha e barit sintetik po ku ka mbet si projekt, nëse prej vitit 2021 deri tash ka pasur ndonjë kontest është mirë me u njoftua qytetarët, çka është duke ndodhur dhe pse nuk po përfundon ky projekt. Unë po e ri përsëris një pyetje e cila ka qenë për Kryetarin e Komunës, mirëpo meqenëse Nënkryetari i Komunës është këtu ndoshta ja delegon, çka është duke ndodhur me projektin e katit shtesë të komunës? Në objektin ku ne jemi, s'jemi në gjendje me mbikëqyrë siç duhet, edhe pse këtu ka qenë një shumë e madhe për ndërtimin e katit të tretë.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje të nderuar kolegë asambleistë dhe të gjithë ju të pranishmit në mbledhje. I nderuar Nënkryetar i Komunës, prapë po ta adresoj problemin e rrugës 'Lumi' në fshatin Miradi të Epërme, ku nuk po merret asnjë veprim në këtë pjesë të fshatit dhe me ju thënë të drejtën, banorët kanë filluar me marrë shumë personale se çka ka komuna kundër kësaj lagjeje, që nuk e bënë asnjë veprim, sepse investim nuk bënë, edhe pse ka shumë nevojë. Po ashtu qytetarët, dëshirojnë ta dinë, se a kanë me marrë përkrahje prej komunës, për t'i kompensuar dëmet që janë shkaktuar gjatë breshëri që ka ndodhë, edhe pse ata kanë bërë kërkesa të ndryshme të cilat i kanë paraqitur në fushën e bujqësisë dhe po dëshirojnë ta dinë, a do të kompensohen apo jo? Problemin tjetër që jemi duke e ngritur disa herë është që në rrugën zona industriale, janë vendosë ato pengesat nga një operator privat 'Petrol Kompania' e cila i ka thyer rregullat e komunikacionit, sepse kjo kompani i ka vendos pesë pengesa, po ashtu sipas informatave i ka shkuar një kërkesë prej komunës që t'i largoj ato, por meqenëse dikush po është shumë më i fuqishëm se institucioni ato pengesa mbesin në rrugë, edhe pas vërejtjes që i'u është dhënë nga komuna. Inspektorët nuk po mundem me krye punën e vetë dhe kjo po shkakton shumë vështirësi. Për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, drejtor cilat prej projekteve të cilat janë përfitues te subvencioneve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e që janë projekte që subvencionohen nga paraja e taksapaguesve, cilat nga këto projekte janë duke u zhvilluar, ose janë zhvilluar ose pritet me u zhvilluar, për shkak të atyre subvencioneve që i kanë marrë. Po ashtu tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, çka ka me ndodhë me hapësirën e shtëpisë së kulturës në 'Miradi të Epërme', e cila është rrënuar para 3 viteve. Po ashtu tabelën që shohim që të dërgon tek Shtëpia e Kulturës, a keni për qëllim me ndërruar atë tabelë apo si? Tek Drejtoria për Arsim, a ka ndonjë investim për renovim ose investim nëpër shkollat e komunës sonë gjatë fazës së pushimeve, sepse ne jemi mësuar që renovimet të fillojnë kur fillon procesi mësimor, pra a keni planifikuar diçka rreth kësaj. Sa i përket ndriçimit publik, ne po kemi shumë pyetje prej banorëve, kur po fillon dhe kur do të ndër merrni diçka. Pyetja e fundit është e banorëve në lagjen 'Idriz Breznica' në qytet, vazhdimisht shkruajnë dhe

ankohen se kur ka me filluar renovimi i kanalizimit dhe rrugëve dytësore në atë pjesë, sepse është në gjendje jo të mirë.

Qëndresa Ademi: Të nderuar dhe të nderuara përshëndetje për të gjithë. Unë kam një pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, qytetarët kanë kërkuar ta dinë, se kur do të mbahen komisionet të cilat qytetarët, kanë bërë kërkesa për mjete financiare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Hasan Ismajli: Kam një pyetje për Drejtoreshën e Bujqësisë dhe Zhvillim Rural, mirëpo nuk qenka këtu, desha ta pyes për dhënien e serave pse nuk e keni publikuar listën e përfituesve, ju kisha propozuar që ta publikoni listën në ueb-faqe dhe ta shohim, edhe vendimin e anëtarëve të Komisionit, që ta dimë se a ka konflikt interesi mes anëtarëve të Komisionit dhe përfituesve. Drejtoria për Infrastrukturë, drejtor keni fillua me punuar dhe një investim që keni bërë tek banesat këtu afër komunës, në një pjesë të parkingut dhe trotuarit kisha dashur ta di arsyen, pse keni filluar pasi që ajo pjesë ka qenë e përfunduar me kubëza betoni dhe e vetmja arsye, për mu ka qenë një pjerrinë, por ajo është problem i atyre të cilët e kanë bërë pranimin teknik, të cilët e kanë pranuar ashtu. Ndërsa ju jeni duke i shpenzuar paratë e taksapaguesve të qytetarëve, investoni aty ku nuk ka nevojë për investim unë dua ta di pse? Nënkryetar i Komunës me datë 14.05.2024, zyrtarisht e kam dërguar një kërkesë në Drejtorinë e Financave dhe Buxhet, ku kam kërkuar të gjitha shpenzimet e veturave zyrtare, brenda oborrit të Komunës dhe deri sot nuk kam marrë përgjigje. Nëse keni mundësi i nderuar Nënkryetar i Komunës me u përgjigj. Po ashtu e kam bërë një pyetje qe pesë muaj, Shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe juve Nënkryetar i Komunës për qëndrimin e juaj për subvencionim e studentëve serb me dokumentacion, ku figuron brenda për brenda Republika e Kosovës - Republika e Serbisë dhe nuk jeni përgjigjë çfarë qëndrimi keni? Kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, pjesa e pazarit këtu në Bresje, pas të martës ajo pjesë shfrytëzohet për parking, nëse ja keni dhënë dikujt me qera, a ka mundësi ta dijim kush është, a ka kontratë dhe sa është pagesa? Tek shkolla 'Mihal Grameno' nuk e di kush është ai person, që ka dhënë leje në oborr të shkollës, të shfrytëzohet për lojëra dhe të gjithë ne jemi në dijëni që rreziku është tepër i madh. Drejtorinë e Urbanizmit, drejtorin po e shoh, por nuk e di, a është në dijëni, a ka pranimit teknik kati i tretë i këtij objekti dhe nëse ka si është bërë pranimit teknik i këtij objekti, ku pjesa jashtë është e pa përfunduar dhe nëse s'ka, si ka mundësi me lejuar me hy punëtorët në katin e tretë pa pasur siguri? Sa i përket lokalit tek Stadiumi për të cilin u fol më herët, unë kam kaluar një ditë rreth orës 19:00h në mbrëmje atje dhe kisha dashur ta dijë, a ka leje dhe nëse ka, kush ja ka lëshuar lejen, pastaj ne vazhdojmë me rrugët e tjera. Laureat e kemi pasur një debat në faqen tonë, unë sugjeroj si mik, kolegë që kur nuk je i sigurtë asnjëherë mos dil me shkrua publikisht, sepse unë mundem me veprua edhe ndryshe, sepse keni deklaruar që unë jam një prej atyre që kam dhënë prona për ndërtime, unë kam lindur në vitin 1961 dhe deri në ditën e sodit në emër timin pronë nuk kam pasur, as tokë. Këtu është Drejtori i Planifikimit Urban shko dhe shikoje kush ka bërë kontratë në atë pjesë ku unë banoj, që ka dhënë pronë për ndërtim. Duhet të kesh kujdes. Unë të kam pyetur sa të ka kushtuar asfalti në oborrin tënd? Nuk kam dashur të them, ta ka shtruar komuna, si keni ardhë këtu Komuna ta ka shtruar asfaltin, mua mos më përziej.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, të gjithë ne jetojmë në Komunën e Fushë-Kosovës, ndërsa unë jetoj në fshatin 'Lismir' dhe secili prej asamblistëve këtu në Komunën e Fushë-Kosovës e dimë për njëri tjetrin kush çka ka. Nëse nuk është me letra në emër tënd, nuk do me thënë që nuk keni përfituar, unë nuk kam thënë që ju keni përfituar jashtëligjshëm, duhet ta kemi parasysh këtë. Sa i përket asfaltit të oborrit tim, të kamë treguar edhe atë ditë, kur ka përfunduar i gjithë asfaltimi i fshatit 'Lismir', ka përfunduar edhe asfaltimi i lagjes sime. Komuna e Fushë-Kosovës ka shtruar

shumë rrugë dhe ne jemi shumë të kënaqur, që u'ka lehtësuar jetesën qytetarëve. Jam në gjendje të ballafaqohem me ju për përfitimet personale, që i kemi marrë nga kjo komunë sepse unë asnjë të punësuar nuk e kam në Komunën e Fushë-Kosovës. Nuk është mirë me folë të pa vërteta.

Mirsad Qyqalla: Duke pasur parasysh gjendjen në teren po na imponohet me bërë më së shumti pyetje për Drejtorin e Inspektoratit, konkretisht çështjen e uzurpimit të hapësirave publike e cila është bërë shumë e rëndë, nuk e di pse ja keni dhënë mundësinë kushdo qoftë ai me ardhur dhe me ta zënë hapësirën dhe mos me i dhënë llogari askujt, kjo po ndodhë veç në Komunën tonë. Kishte qenë mirë ose me mbyll Drejtorin e Inspektoratit krejt, ose me dal dhe me ja pa punën pak. Unë i thash edhe Hasanit e kini mbështetjen time, nëse këta kolegë janë për një mbledhje të jashtëzakonshme vetëm me shtyer drejtorin që të hyn në funksion të punës, sepse ne nuk kemi me askënd asgjë personale, mirëpo gjendja faktike është e tmerrshme. Dua që të ndalem pak edhe tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, meqenëse edhe drejtori qenka prezent. Drejtor me çështjen e ndriçimit, kam parë që para një muaji i keni publikuar disa fotografi dhe unë kam pritur që ka me pasur shfaqjesim komuna, për kohën që ua ka marrë pa drita, në ueb-faqen zyrtare, kompanitë të cilat po e marrin tenderin mund të them lirisht se 90% e ndriçimit është jo funksional, kjo është gjendja për tri vite radhazi. Nëse mua më pyet një qytetar i fshatit tim, se kur do të rregullohet ndriçimi, a mundem me ja dhënë një përgjigje të saktë. Tash keni një kompani të re dhe besoj se kur e ka marrë tenderin, e ka ditur se çka ka me punuar, e dinë gjendjen ku ka dhe ku nuk ka ndriçim, kjo është shumë shqetësuese për të gjithë qytetarët. Po ashtu a keni filluar me dezinfektimin dhe a ka ndonjë plan sepse në kushte normale, kjo kishte dashur që të jetë e përfunduar. Drejtori i Arsimit, nuk është prezent, u fol shumë edhe për lodrat në oborrin e shkollës 'Mihal Grameno' unë kisha propozuar që edhe klasat me e lëshuar me qera për diasporën, ndoshta fitojmë më shumë. Shumë më keq e kemi pjesën e parkingjeve. Unë dëshirova që edhe këtë pyetje t'ia parashtroj Drejtorit të Arsimit sepse e di se e kemi një kontratë 6,000.00€ për disa orë dhe disa dhurata për penzionerë, deshta ta përmend me emër z. Asllan Qyqalla të cilit i thashë se komuna jep dhurata për penzionerë dhe ai më tregoj që atij nuk i kanë dhënë. Unë i kamë parë disa që ua bëjnë dhurata dhe falënderime, ndërsa tek dikush jo pse arsytimi i komunës, ka qenë që këto dhurata janë për pensionimin e punëtorëve të Komunës dhe këtë të drejtë, duhet ta kenë të gjithë pa dallime. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, drejtor meqenëse një mbledhje keni munguar ju, një mbledhje kam munguar unë, e kam përcjellë një listë të subvencioneve, pashë disa Organizata Jo Qeveritare që kanë pas disa aktivitete me fëmijët me nevoja të veçanta, a keni një listë të këtyre përfituesve se çfarë aktivitete bënë, se me sa pashë unë një person që është përfitues, mirë me atë punë tjerat ishin zero, po ashtu pash edhe subvencionin që kishit dhënë një personi i cili po shkruante 'Letër motivuese - CV', cila është rruga me ju drejtuar atij individit, që ai të na mëson si ta bëjmë një CV - letër motivuese, e cila ishte një vajzë përfituese, i kam parë titujt e subvencioneve dhe me të vërtetë me të hutuar a mbani përgjegjësi që keni krijuar parazitë, jeni duke e krijuar një grupe të njerëzve, që në kohën e subvencioneve i marrin mjetet dhe ne si anëtarë të Kuvendit të Komunës, që e kemi votuar buxhetin e kemi të pa qartë cila është veprimtaria e tyre, mirë kishte me qenë të na sqaroni ndoshta ka edhe prej atyre me plotë meritë, mirëpo një shumicë e përfituesve me të vërtetë është e pa qartë. Një pyetje e kam edhe për Drejtorin e Administratës, për raportin e auditorit, zyrën e auditorit të brendshëm, ju e kishit përjashtuar prej funksionit dhe për mua ky është lajm. Meqenëse ai po vazhdon me qenë auditor i brendshëm dhe po merre pagë këtu atëherë, a është fajtor Komisioni që e ka vlerësuar që duhet me marrë atë vendim, apo realisht keni gjetur ndonjë nen, që duhet me përjashtuar.

Hasan Ismajli: Kryesues me marrjen e mandatit nga kjo foltore shoqërisht kam apeluar, që ta ruajmë gjuhën dhe të mos mirremi me çështje personale, unë e di se me Laureatin në një statut që ky e kam postuar në lidhje me regjistrimin e popullsisë, kam reaguar dhe i kam dhënë qëndrimet e mia, të cilave ju qëndrojnë, ndërsa ju i keni marrë në mbrojtje ata të cilët unë ju kam thënë hajna dhe ata e dinë që janë hajna, sepse mos me ditë vazhdojnë me procedurat tjera, ashtu siç e kam dërguar unë listën e Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, sepse unë kam folë për atë listë dhe nuk merrem më me të, por ju më keni thënë se ju jeni një nga pronarët e tokave dhe unë s'jam pronarë i asnjë toke dhe kurrë s'kam qenë. Unë i kamë banesat e mia pasi që e kam një vëlla i cili e ka zemrën e madhe dhe mi ka falë këtë, e dëshmoj me kontratën e noterizuar nga Noterja. Vëllau im i ka pasur dhjetë ari e pesëdhjetë metra dhe jo unë, sepse unë nuk jam pronarë. Mos u merr publikisht me ato çështje, për të cilat nuk je i sigurtë, të cilat nuk keni informata të sakta, sepse kurrë unë dhe familja ime, as një cent prej subvencioneve në Komunë nuk kemi përfituar. Bashkëshortja ime punon në Komunë, e cila është punësuar në vitin 2000 dhe është magjistër e arkitekturës, e të cilën e kanë marrë si kuadër dhe unë kam thënë, nga kjo foltore që të gjitha lëndët e saj, prej viti 2000 deri më vitin 2024 auditori dhe nëse vetëm një fjali, nëse e gjeni që e ka shkelur ligjin dërgon në prokurori.

Habib Mekolli: Përshëndetje për të gjithë. Pyetjen e kam për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, po ashtu edhe për Drejtorin e Kadastrit, tek 'Kompleksi 300' i kemi parë kohën e fundit disa punime, që kanë filluar nga Komuna në anën e përparme. Ndërsa disa banorë që banojnë në anën e pasme të këtij objekti, kemi ankesa dhe kërkesë që një hapësirë publike është e uzurpuar, me disa garzha metalike të vjetra dhe sipas disa informatave janë zyrtar të Komunës, pronarët e këtyre garzhave, kisha kërkuar që drejtori të na jap informata, a është pronë publike kjo pjesë dhe kur do të lirohen, sepse ne të gjithë jemi dëshmitarë, se ka shumë pak gjelbërim në komunën tonë. U përmend edhe oborri i shkollës 'Mihal Grameno', i cili po shfrytëzohet për lodra, e dëgjova herën e parë Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, i cili tha se fëmijët po kënaqen, unë ju kisha pyetur, se a kënaqen me ju dhënë edhe substanca narkotike, a është e lejuar në oborr të shkollës të vendosen këto lodra, a ka mundësi ndonjë zyrtar me na sqaruar, se kjo është brenda normave edukativo - arsimore. Unë e përsëris vazhdimisht një kërkesë, ku jashtë oborrit të shkollës dhe jashtë oborrit të çerdhes, kemi një numër lokalesh të vjetra, këto hapësira të cilat janë rreth shkollave dhe çerdhes, kishte me qenë mirë me i liruar. Kam pas informata prej Ish/Drejtoreshës së çerdhes, e cila më ka treguar se ka bërë kërkesë disa herë për lirimin e këtyre hapësirave, sepse të gjithëve po na pengojnë. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, disa herë po i publikon punët e kryera, unë mbrëmë kalova në rrugën 'Dardania' në shesh, mirëpo puna në teren nuk ishte e mirë. Raporti i auditorit thotë që ka gjetur shkelje në vendosjen e kamerave, në të cilat janë dhënë pesë qind mijë euro dhe ka shkelje. Kishte qenë mirë që të rregullohet edhe zërimi në sallë për të qenë më transparent me qytetarët.

Migjen Kolshi: Kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit, mirëpo me qenë se drejtori nuk qenka prezent po e lë për mbledhjen e radhës. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorinë e Planifikimit Urban, drejtor pronat të cilat jepen për ndërtim, a kalojnë në prona publike, a mbesin në emër të personit i cili e lëshon tokën për ndërtim, nëse jetë në emër të personit, që e lëshon tokën për ndërtim, atëherë ajo prona nuk është pronë publike? Pyetjen tjetër e kam për Drejtorinë e Administratës, drejtor kush është Shefë në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit? Po ashtu desha të pyes, se a ka të drejtë personi të jetë Shef në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të punoj në prokurim?

Aida Alimi: Përshëndetje për të gjithë. Fillimisht kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të na kërkoj falje komplet grave këtu që jemi, sepse në debat tha jeni bërë si gratë, unë kërkojë

publikisht me na kërkuar falje. Po vazhdoj me pyetjet të cilat i kam përgatitur. Pyetja ime është, kur do të jenë funksional mikrofonat? Po ashtu Këshilli Komunal i Sigurisë në komunën tonë, nuk vjen me na raportuar asnjëherë në Kuvend dhe pyes kur do të vjen, ky këshilli i sigurisë me na raportuar në komunën tonë. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorinë e Planifikimit Urban, ka filluar të ndërtohet pjesa kah lagja e 'Bresjes', a keni marrë parasysh çka ka ndodhë në pjesën e lagjes së 'Dardanisë', kanalizimet ujësjellëset kishte me qenë e rrugës, me i marrë hapat para kohe, për t'i rregulluar gypat e kanalizimit, pastaj mos me pas probleme siç kanë në pjesën e lagjes së 'Dardanisë', po ashtu kërkohet që në asnjë ndërtesë të mos bëhet pranimi teknik, pa qenë në rregull objekti sepse pasojat po i vuajnë qytetarët. Pyetja tjetër, a ka kompani ndërtimore e cila i ka borxh komunës, për leje ndërtimore dhe sa është shuma e tyre, nëse ka sa është numri i tyre dhe çfarë do të ndërmermi që t'i detyroni për ti paguar borxhet. Kam edhe një kërkesë nga një qytetare e 'Sllatinës së Vogël', të cilës pusetat i kanë mbetur të hapura, qytetarja është znj. Merita Kelmendi rruga 'Shpati', po ashtu kërkohet nga kryesuesi që të plotësoj komisionin për emërimin e rrugëve, sepse për shkak të mos plotësimit të këtij komisioni, nuk po kam mundësi me thirr mbledhjen dhe me vazhduar punën time si Kryesuese e këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju kërkohet falje për lëshimin të cilin e kam bërë, nuk e thash me qëllim dhe keni të drejtë që ma tërhiqni vërejtjen. Ndërsa sa i përket komisionit, ky komision nuk është funksional, që dhjetë vite, nuk po funksionon. Ju me keni shkruar në e-mail, ku ju keni drejtuar edhe Ekzekutivit të Komunës, sepse është në domenin e tyre kjo punë, e kemi diskutuar dhe Ekzekutivi i Komunës nuk i ka dërguar emrat e vetë, për me plotësuar këtë komision. Besoj që Nënkryetari i Komunës, ka me marrë me seriozitet dhe do të na ndihmon në këtë drejtim.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje për të gjithë, i kam disa pyetje të banorëve, por deshta të ndërlihem njëherë tek çështja e lodrave në shkollën 'Mihal Grameno', deshta të ndërlihem me drejtorin i cili po replikon nga vendi, vajza ime e cila është tetë vjeçe, kur ka shkuar tek lodrat e ka parë kabllon e lodrave brenda shkollës dhe më tha, se edhe rrymën po e merrshin në shkollën time. Pyetja ime është kush e paguan fakturën e rrymës? Ne nuk jemi kundër argëtimit të fëmijëve, mirëpo kisha dashur të më sqaroni, se çka janë këto letra të cilat shiten në free-shopin përballë shkollës, ku i marrin fëmijët dhe i mbështjellin substancat narkotike. Tash unë me dërguar vajzën time dhe mi thënë shko dhe kërkohet një kësi letre, pronari i lokalit të free-shopit menjëherë ja jep, çka po u'a merr mendja a jemi duke i shkatërruar fëmijët tonë? A thua kush do ta marrë përgjegjësinë, drejtor nuk jemi kundër lodrave, por jemi kundër kësaj, sepse nuk jemi dal me bërë politikë por jemi dal mi mbrojt qytetarët tonë, ne me dorën tonë, jemi duke i shkatërruar fëmijët tonë. Pyetjen tjetër e kam për Drejtoreshën e Shëndetësisë, a kanë të drejtë të punësohen qytetarët e komunave tjera: Drenas, Prishtinë, Obiliq, para qytetarëve të komunës tonë, sepse saktë kam informacione që janë punësuar shtatë deri në tetë persona, që nuk janë banorë të komunës sonë. Pse janë pezulluar lëndët e qytetarëve të cilat kanë qenë para tri viteve, që ka pasur vërshime. Rruga 'Kongresi i Lushnjës' në Fushë Kosovë, punëtorët e pastrimit dalin dhe ecin tre qind metra, e marrin kontejnerin se nuk e zënë kamionin me hyrë në këtë rrugë, për arsye se i kanë zënë hapësirat publike, kur do të dilni në vend e ngjarjes do ta shihni. Deshta të pyes edhe për punëtorët e projektit të 'Karitas Kosova', të cilët janë për dhjetë vite në punë, a janë të përfshirë në listën e shujtave tek pika e pestë e rendit të ditës?

Fisnik Sllamniku: Përshëndetje për të gjithë, diskutimin e parë e pata me Drejtorin e Arsimit, i cili nuk qenka prezent, deshta me diskutuar për përgatitjet e fillimit të vitit shkollor, deri ku kanë shkuar me konkurse dhe gjana të tjera? Deshta të diskutoj edhe për orientimin strategjik të shkollave të mesme, pasi që e dimë që në fshatin 'Bardh i Madh', ekziston një objekt dhe shkolla e mesme nuk është obligative dhe ndryshimet e lokacioneve, kishim mundur të funksionalizohen

dhe me dërguar një zhvillim edhe në 'Bardh të Madh', në këtë mënyrë e kishim liruar vendin këtu, e kemi diskutuar edhe me herët. Një kërkesë të banorëve për çështjen e paushallit të ujit, a është problemi tek qytetarët apo tek ujësjellësi, i cili nuk ka faturuar në mënyrën e duhur ju kisha lutur me pas një diskutim si Drejtori e Shërbimeve Publike me Kompaninë e Ujësjellësit. Sa i përket ndriçimit publik, në stacionin e autobusëve desha ta di, deri ku kanë shkuar procedurat me ndriçim dhe në çfarë afati kanë me u vendosur. Për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e kemi diskutuar për shkak të mungesës së jashtme të fushës në fshatin 'Vragoli', është duke u dëmtuar salla, muri pjesa e fasadës në fushë, deshta ta di se a keni fillua me renovuar? Kisha kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që në dy vitet e ardhshme të ndërmerri masa për largimin e mbeturinave në 'Ramnishtë' në fshatin Vragoli.

Jetmir Berisha: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Pyetja ime është, a kemi me marrë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës për rrugën 'Bardh i Madh - Graboc i Poshtëm', pasi që është një ndër rrugët më të dëmtuara momentalisht dhe po kemi shumë dëmtime të veturave, po ashtu banorët frekuentojnë çdo ditë andej, ne e dimë se është rrugë regjionale dhe është në kompetencën e Ministrisë, por ne kemi bërë kërkesë, ku ajo kërkesë është dërguar dhe ende nuk kemi marrë përgjigje. Me të vërtetë është e pakalueshme. Pyetjen tjetër e kam për ujësjellësin në fshatin 'Graboc i Poshtëm' ku jemi në pritje të një përgjigje, pasi ka mbetur i anashkaluar me rrjetin e ri në fshatin 'Bardh i Madh' pjesën tjetër, ne si komunë i kemi nda mjetet financiare dhe një pjesë e madhe e fshatit është instalimi që ka ndodh më herët, mirëpo në pjesën tjetër mungon instalimi i ri dhe pjesa që e lidh 'Bardhin e Madh' dhe 'Grabocin e Poshtëm', është gyp shumë i vjetërsuar, shpresoj që do të mirren hapa për zgjidhjen e këtij problemi, sepse janë bërë shumë vite që kemi probleme me ujë të pijes.

Shpend Bardiqi: Kemi marrë një njoftim që shkollës së futbollit 'Kosovari' ju ka ndaluar transporti për bartjen e fëmijëve, pyetja ime është pse është ndaluar transporti? Ne kemi dëgjuar se për arsye, se i kanë bërë disa fotografi me një anëtarë të Vetëvendosjes dhe Partisë Demokratike të Kosovës, kjo është shumë e ulët, nëse për këtë arsye ju ka ndaluar transporti këtyre fëmijëve. Më herët ka qenë një projekt prej Ministrisë, për banim kolektiv, banim social desha të pyes, a ka aplikuar Komuna e Fushë-Kosovës për një pronë, për mu ndërtuar një objekt banesor prej Ministrisë. Për Drejtorinë e Arsimit, kam një pyetje, a ka mundësi me u postuar emrat e atyre të cilët kanë marrë bursa prej Drejtorisë së Arsimit, sepse ishte një numër shumë i madh, një shumë e madhe? Unë e kam edhe një propozim për lodrat, të cilat i kanë vendos tek shkolla 'Mihal Grameno', ndoshta do të ishte mirë edhe shkollat të shfrytëzohen në këtë drejtim gjatë stinës së verës. Kam disa kërkesa për ndihma në shëndetësi që ju duhen për gjana të ndryshme, duke filluar prej patericave, te sëmurëve me kancer, dua të ju pyes sa është fondi dhe si mundem me ju ndihmuar këtyre njerëzve, që kanë shumë nevojë, nëse nuk kanë mundësi financiare, nëse ka mundësi me na treguar, si mundemi ne me ju ndihmuar. Trotuaret që po prehen, a marrin leje, nëse nuk marrin leje, a ka ndonjë raste në Komunën e Fushë Kosovës, që një person e ka prerë asfaltin e komunës, në pjesën e rrugëve publike dhe komuna e ka dënuar.

Artan Asllani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, kam një pyetje për Nënkrjetarin e Komunës, ne e dimë se komuna jonë nuk ka fond emergjent dhe me 20.07.2024, ka qenë shumë frymë e madhe dhe janë dëmtuar kulmet e shtëpive, a mundemi me formuar një komision me dalë dhe për të vlerësuar dëmet dhe me ju ndihmuar, sepse kushtet janë shumë të rënda, qytetarët kanë dërguar kërkesa tek unë, këtë çështje e kam ngritë edhe në Komitetin për Komunitete. Unë kam biseduar edhe me Shefen e Zyrës për Komunitete dhe me ka treguar se nuk ka fond, kishte qenë mirë Nënkrjetar i Komunës, me pa, se si mundemi me zgjedh këtë çështje, pyetja e dytë është për Drejtorin e Administratës, disa prej atdhetarëve që kanë ardhur prej

mërgatës në pushime, kanë bërë kërkesë për kurorë dhe ju është thënë, se duhet me pritë deri në dy muaj për një kurorëzim, ata e kanë adresuar këtë çështje tek unë dhe me kanë kërkuar që të bëhet një zgjidhje, e falënderoj Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, për një pyetje të cilën i'a kam dërguar me shkrim dhe fatmirësisht brenda minutave, më është kthyer përgjigja në e-mail zyrtar dhe është intervenuar. Nëse vazhdojmë kështu koha e pyetjeve do të ishte shumë më e shkurtë.

Nënkryetari i Komunës: Përgjigjen për Kryetar të Komunës nuk mundem me ta dhënë tani, mirëpo do ta japë në tetor të vitit të ardhshëm, mirëpo le të jetë Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Burim Berisha për mandatin e ardhshëm. Unë do të jemi i gatshëm me qenë këtu për pyetjet dhe përgjigjet, ndërsa nuk jam i gatshëm me kanë në disponim të juaj për opinionet, sepse jemi tek rendi i ditës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', unë po e kam vështirë edhe me i identifikuar pyetjet e juaja, i nderuar Kryesues po më vjen shumë keqë, por unë nuk do të jem në gjendje si Nënkryetar i Komunës të diskutoj për opinionet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, sepse këta janë të lirë mi dhënë opinionet e veta dhe nuk kam të drejtë me javë ndaluar. Asambleisti z. Durimi pyetjen e parë e ka pasur rreth, dhënies së hapësirës së oborrit të shkollës 'Mihal Grameno' me qera, ka leje, këtë leje e ka lëshuar Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në bazë të udhëzimit administrativ, që ka të bëjë me menaxhimin e shkollave, në pjesën e sezonit veror, në aspektin e legalitetit është konsideruar e ligjshme, në aspektin e legjitimitetit është çështje relative dhe mund të kemi mendime tona, unë jam kundër që të jepen oborret e shkollave, pjesën e shpenzimeve tjera siç u cek rryma, kam parë që kompania është duke i paguar faturën ku dje e ka paguar faturën në vlerë prej: 243.00€. Pyetja tjetër rreth renovimit të shkollave, sivjet kemi vetëm një renovim të shkollës 'Selman Riza', të cilin do mundohemi ta merremtojmë dhe të krijojmë kushte më të mira, ne jemi në fazën përfundimtare me Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për ndërtimin e një shkolle të re, para dhënies së lejes. Shkolla 'Selman Riza' është më e vjetra dhe me kohë do të vendosim, a do shkojmë renovim komplet apo rrënim total. Në renovim është edhe çerdhja publike, po ua jap këto përgjigje për arsye, se Drejtori i Arsimit nuk është këtu, sepse është me një referim në të cilin ka të drejtë me shkuar në ditën e pushimit të tij. Sa i përket uzurpimit të parkingjeve, trotuareve terrasave, ne kemi filluar pjesën e përgatitjeve për një aksion të madh, ku do të eliminohen dhe do asgjësohen të gjitha pa përjashtim, drejtoritë përkatëse kanë marrë disa prej udhëzimeve, procesi nuk është i thjeshtë, se disa mund të kenë leje të përkohshme, por jemi në përgatitje të këtij aksioni brenda këtij mandati. Sa i përket çështjeve të serrave, unë mund ta konfirmoj se është dalë lista përfundimtare e serrave dhe ka filluar zbatimi. Pyetja tjetër ka qenë për listën e studentëve dhe për ndihma në shëndetësi, ku sa i përket organizatave tek sektori i shëndetësisë është kryer javën e kaluar, ka filluar pagesa e subvencioneve, ndërsa sa i përket rasteve individuale për ndihmë në shëndetësi, sot ka filluar punën komisioni për shqyrtim të tyre. Asambleisti z. Hasan Ismaili, ka pyetur për subvencionimin e studentëve serb, mesa jam unë i informuar prej vitit që unë jam këtu, nuk ka ndarje të subvencioneve për komunitetin serb, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet, ndarja e fundit e cila është bërë nuk është ekzekutuar pagesa, për këtë vitë unë nuk kam as një informacion që ka të tillë, unë mendoj se kanë të drejtë të subvencionohen të gjithë ata që i plotësojnë kushtet e konkursit që është shpallur nga Drejtoria e Arsimit, mirëpo nuk pajtohem që të jenë struktura ilegale paralele, që mund të funksionojnë, tani unë nuk kam përgjigje përfundimtare, mirëpo me Universitetin e Mitrovicës, kjo është një çështje shumë specifike dhe po ballafaqohet edhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, sepse është i pranuar si universitet dy herë, ne kemi kërkuar nga Ministria, që të na ndihmon rreth kësaj çështjeje. Sa i përket pyetjes për rrugën 'Sllatinë e Madhe - Graboc i Poshtëm', ne kemi bërë

kërkesë në Ministrinë e Transportit, po ashtu ka qenë edhe Zëvendës Ministri këtu, ne kemi kërkuar që Komuna e Fushë-Kosovës, të jetë përfituese për këtë rrugë dhe kemi konkuruar edhe me dy projekte tjera, ndërsa Ministria e Transportit e ka pa të arsyeshme, që të financoj një rrugë tjetër dhe na kanë thënë, se ne po e ndihmojmë komunën me një rrugë lokale, përmes këtij fondi, ne kishim një kontratë për rehabilitim të rrugëve lokale, e kemi parë si të nevojshme që t'i bëjmë disa intervenime tek dy pjesë, një pjesë e shkurtër në 'Bardh të Madh' dhe një pjesë në 'Graboc të Poshtëm' me fondet e komunës, kemi biseduar edhe me Ministrin që të na jap një pëlqim, që ne të vazhdojmë me kontratën tonë, për t'i bërë disa intervenime tek kjo pjesë e rrugës, që ka qenë më urgjente për ta bërë. Ishte një pyetje për punëtorët që janë ushtrues detyre ku marrin rroga, këtu kam vërejtur një fenomen relativ të shtuar, që punëtorët kanë një kontratë pune dhe pastaj me vendim caktohen me detyra tjera, ne tani jemi të obliguar për fillimin e zbatimit të 'Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës', ku ne kemi angazhuar një ekspert dhe e kemi themeluar një grup punues, tani grupi punues dhe eksperti, kanë filluar që të punojnë në rregullore dhe në muajin shtator, ne do ta sjellim si propozim për miratim në parim në Kuvendin e Komunës 'Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale'. Rregullorja do të përmbajë, organizimin e ri të komunës, përshkrimin e punës për secilin drejtor, për secilin sektor, përshkrimin e detyrave të punës për secilin punëtorë që punon në komunë, po ashtu skemën e organizimit të ligjit të ri të pagave dhe koeficienteve, do bëhet riorganizimi i komunës.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale: Dua të përgjigjem në pyetjen që parashtroi asambleistja znj. Qëndresa Ademi, komisioni ka filluar punën dhe është duke i shqyrtuar lëndët, besoj që brenda dy dite i përfundon. Pyetja tjetër nga znj. Dardane Sogojeva Shala për pranimin e stafit nga komunat e tjera, se a kemi të drejtë të marrim punëtorë, që nuk janë banorë të komunës së Fushë-Kosovës, tani Ligji për zyrtar publik, e rregullon këtë çështje dhe para ligjit janë të gjithë të barabartë.

Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit: Kam pas vështirësi t'i dëgjoj pyetjet për shkak të zhurmës dhe të gjitha pyetjet, do t'i marr nga procesverbali dhe do ju përgjigjem në mbledhjen e radhës.

Drejtori për Planifikim Urban: Kam një pyetje nga asambleisti z. Migjen Kolshi, lidhur me statusin e pronës të cilën është ndërtuar objekti kolektiv shumë banesor, si rregullohet me ligj dhe e kujt mbetet prona, në momentin kur objekti fillon me u ndërtuar, ekziston një kontratë që i rregullon raportet pronësore, pronari i tokës dhe investitori, deri në momentin kur objekti pranohet teknikisht ajo pronë është e personit të cilit e ka lëshuar tokën për objekt kolektiv, me marrjen e certifikatës së pronësisë dhe regjistrimin e njërive banesore, ai pronar nuk mundet më me marrë pronën e vetë, nuk mundet me përdorë për hipotekim se në komunë si kundërvlerë e ka regjistruar njësitë afariste banesore, për ndryshe kjo çështje mbetet me u rregulluar me Ligjin për Bashkëpronësi, që me u bë bartjet finale në Drejtorinë e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës. Ligji për Bashkëpronësi e shtinë investitorin me bërë një ri parcelim, shputa e objekti etiketohet në kadastrë, i jepet edhe një perimetër mbrojtës, i cili është proporcionalisht i të gjithë banoërve, ndërsa prona tjetër kalon në pronë publike, si pasuri komunale dhe infrastruktura rrugore, pra kjo punë rregullohet me Ligjin mbi Bashkëpronësinë. Sa i përket pyetjes së znj. Aida Alimi, çështjes së ndërtimit të zonës kadastrale Fushë-Kosovë, pjesa e Bresjes, komuna është në realizim të dy projekteve të kanalizimit, shtrirja e rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe fekal në rrugën 'Tahir Zemaj', ku po thuaj se 90% e kontratës ka përfunduar dhe e ka realizuar një punë shumë të mirë dhe funksionale, që e zgjedh problemin e zonës së Bresjes, pjesa e fundit në distancë prej 100m, ka mbet pa u realizuar për shkak mundësive teknike në teren. Ne i kemi dhënë edhe një afat duke i pritur zhvillimet në teren, nëse hapet mundësia me intervenuar, nëse jo kontratën do ta mbyllim

si të tillë, paralelisht tani është në punim edhe ndërtimi i rrjetit të kolektorit për ujera të zeza dhe atmosferike në pjesën fundore të lagjes së 'Bresjes', aty do të jetë një kolektorë me dimensione më të mëdhaja, material nga betoni, operatori është në proces të punës dhe besoj që këto dy projekte e rregullojnë çështjen e kanalizimit të kësaj zone. Pyetjen tjetër e kam nga asambleisti z. Durim Hajra, për përfundimin e katit shtesë, vlera e kontratës ka qenë katër qind e pesë dhjetë mijë euro, ne kemi mbërrirë tani në fazën e fundit dhe vonesa ka ndodh, për arsye të vështirësive të fasadës ventiluese, i vetmi pozicion i pa përfunduar është fasada e jashtme, ne i kemi dhënë edhe një afat operatorit ekonomik për realizimin e këtij pozicioni, në të kundërtën nëse nuk mbërrijmë me u siguruar edhe ky pozicion, ne do të hyjmë në shkëputje të kontratës, do bëhet prerja do paguhen pozicionet e realizuar përfundimisht, do bëhet një shkëputje dhe ri tenderohet vetëm pozicioni i realizimit të fasadës së katit shtesë. Fasada duhet jetë e njëjtë me specifikat ekzistuese. Shuma e pa paguar është 41,000.00€. Në cilësinë e menaxherit të kontratës jam unë dhe Nexhat Bajqinca, ne kemi bërë një pranim të përkohshëm, sepse vetë pagesa e situacioneve, të cilat pranohen paguhen, këto janë pranim i përkohshëm për situacionin, sistemi i klimatizimit ka qenë situacioni i fundit dhe ne kemi pranuar raportet të realizuara. Unë nuk kam data bazë të saktë të borxheve që kanë kompanitë ndërtuese komunës, mirëpo në raportin e auditimit i kam parë që disa kompani kanë borxhe të vjetra, ku një prej kompanive e kam në proces të legalizimit, borxhet akumulohen në momentin që kompanitë vijnë për certifikatën e përdorimit ose për procedurë të legalizimit, me faktin se janë borxhli në pjesën dërmuese këta operator kanë tejkalim të lejeve ndërtimore, si të till trajtohen me Ligjin për legalizim, për marrjen e certifikatës së legalizimit ata janë të detyruar paraprakisht ta paguaj borxhin, e pastaj ta paguajnë edhe pjesën e tejkalimit të lejës ndërtimore për me mundur me regjistruar njësinë banesore, numrin nuk e di saktë por mbledhjen tjetër mundem me ju sqaruar.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përshëndetje për të gjithë. Për mua është hera e dytë që po dalë në foltore në cilësinë e Drejtorit dhe jam shumë i kënaqur dhe privilegjuar nëse dal para juve dhe ju përgjigjem, të nderuar/a anëtarë të Kuvendit të Komunës. Mirëpo unë nuk do të lejoj, me shfrytëzuar dinjitetin tim dhe personalitetin tim për arsye politike, unë ju njoh të gjithëve personalisht dhe e di se ju nuk keni asgjë personale me mua, por nëse dojmë me vazhduar dhe me qenë korrekt me njëri - tjetrin dhe unë me dalë para juve, me shumë kënaqësi kisha dashur që të jeni më të kujdesshëm, sepse ne nuk mundemi me bërë politikë, ndërsa ju mundeni me bërë. Dikush nga asambleistët tha, po e shoh një drejtor atje, është e vërtetë që ne jemi të ulur atje, sepse ju jeni në rend të parë dhe ne jemi pas juve, kështu që unë e morra si ofendim dhe unë mbledhjen e kaluar nuk kam qenë prezent, sepse kam qenë në pushim vjetor dhe një prej asamblistëve ka thënë ndoshta drejtori u lodhë, është e vërtetë që jam lodhur, sepse punë ka shumë, po nuk e kemi ndër mend me u dorëzuar. Ju e dini se çdo kërkesë nga qytetarët ne e trajtojmë veç e veç, pa përgjigje nuk keni mbet asnjëherë. Pyetja e ndriçimit publik u bë këtu shumë problem, për shkak që nuk ka pasur kontratë, por tani e kemi një kontratë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe operatori është shumë i përgjegjshëm dhe po punon mirë dhe shpejtë, kështu që unë ua kisha dhënë edhe një raport të shkurtër, ku kemi filluar dhe deri ku kemi me vazhduar. Qyteti i Fushë-Kosovës ka përfunduar me dy lagje, lagjen 'Nakarada' dhe 'Bresjen' në tërësi, ku operatori ka shkuar në të gjithë rrugën, mirëpo disa rrugë kanë probleme më serioze që kompania e mirëmbajtjes nuk ka kapacitet për t'i përmirësuar si: rruga 'Gjergj Fishta', 'Regjep Mala', por këto rrugë ju premtoj se kanë me u rregulluar. Kompania ka përfunduar edhe fshatin 'Lismir' i ka përfunduar edhe dy fshatrat: 'Sllatinën e Vogël' dhe 'Sllatinën e Madhe', momentalisht është duke punuar në rrugën 'Bllata' në fshatin Miradi e Poshtme dhe shumë shpejt do të vazhdoj me fshatin 'Miradi e Epërme'. Kanalizimi atmosferik për arsye të vërshimeve të fundit ka shkaktuar dëm në rrugën 'Rexhep

Mala' në Fushë-Kosovë, ne kemi intervenuar me një zgjidhje të përkohshme, sepse aty duhet të intervenohet më shumë dhe të bëhet kanalizimi fekal dhe atmosferik. Drunjët dekorativ është projekti për lagjen 'Dardania', pse nuk po vazhdojnë me vendosjen e mbrojtësve, ne kemi menduar që njëherë me i përfunduar të gjitha, ky projekt pritet të përfundoj në muajin dhjetor. Vjedhja e kapakëve të pusetave është problem gjeneral i komunave. Kjo është detyrë e policisë ku ne edhe u'a kemi lehtësuar punën, me vendosjen e kamerave. Prej që është krijuar Drejtoria e Infrastrukturës, në komunën tonë kjo është në përgjegjësin e saj prerja e rrugës. Tek rruga 'Pajazit Islami', e ka bërë një kyqje në ujësjellës dhe ka intervenuar shumë shpejtë, ku e kanë prerë vetë dhe e kanë rregulluar vetë. Po vazhdoj me rrugën 'Idriz Breznica', kanalizimi dhe renovimi kjo pyetje është në Drejtorinë e Infrastrukturës, por po e jap një përgjigje gjenerale është një procedurë me vendosur në buxhet dhe me nda një buxhet për vitin e ardhshëm për këtë rrugë. Pyetjen për dëmet gjatë breshëritë dhe reshjeve të fundit, ne e kemi formuar një komision dhe komisioni do ta bëjë punën e vet, ku ne e dërgojmë në Ministri dhe Agjensioni e Emergjencave, duhet me bërë ndarjen e buxhetit për kompensim, sepse komunës nuk i kanë lënë buxhet për këto rastet emergjente. Asambleisti z. Hasani e ka bërë një pyetje për parkingun, që po shfrytëzohet tek tregu, aty është një hapësirë publike, ku me kanë ardhur disa kërkesa për shfrytëzimin e asaj hapësire për arsye biznese, tani Komuna e Fushë-Kosovës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që është kompetente për hapësirat publike nuk jep pëlqim për shfrytëzim të hapësirave publike për arsye biznese, një pëlqim që më ka ardhur në drejtorin time, e ka refuzim, mbetet në kompetencën e policisë dhe inspektoratit, unë nuk kam informata që shfrytëzohet ajo pjesë. Pyetja tjetër për pastrimin e rrugëve, është i paraparë për vitin 2024, ku është një buxhet prej: 80,000.00€, unë e kam bërë para masën dhe projektin e kam dorëzuar në prokurim, kjo është vonuar, mirëpo është në kompetencat e prokurimit deri sa ta përfundojnë punën e tyre, por besoj që shumë shpejtë kanë me marrë kontratën. Pastrimi që është bërë në rrugën 'Dardania' është Marrëveshje Bashkëpunimi me Kompaninë e Pastrimit - Njësia në Fushë-Kosovë, e cila e ka për obligim për të pastruar pikat grumbulluese, mirëpo në bashkëpunim me kompaninë kemi pastruar edhe rrugën 'Dardania'. Patëm edhe një pyetje, edhe për erën e cila po kundërmon në rrugën 'Dardania', sipas ligjit Ujësjellësi Rajonal i Prishtinës, e ka për obligim dy herë në vitë me pastruar kanalizimin fekal. Sa herë kam bërë shkresë për me intervenuar në rrjetin e kanalizimeve, ata po me përgjigjen se nuk kemi kapacitet me mbuluar edhe Fushë-Kosovën. Mirëpo në afatin e radhës, unë prapë do të bëjë kërkesë për pastrimin e kanalizimit, sepse e kanë edhe obligim ligjor. Kam marrë një pyetje edhe nga z. Fisnik Sllamniku, për faturat e ujësjellësit, ku unë ju kisha propozuar me shkuar dhe me folë me zyrën e ujësjellësit, sepse ata janë kompetent. Kemi një projekt ku vlera e tij është afër një qind mijë euro, përballë stacionit të autobusëve, jemi duke i ndërruar dhe besoj se shumë shpejt do të përfundon. Deponia ilegale në rrugën 'Ramnishtë' këtë ankesë e kemi marrë edhe prej banorëve, tani e kemi edhe prej juve, unë për vitin 2025 kam kërkuar me ndarë një fonde për eliminimin e deponive ilegale, sepse për këtë çështje duhet të shpallet një tender. Shpresojmë se kërkesa jonë do të shkoj deri në fund. Po ashtu dua të jap përgjigje për asambleistin z. Shpend Bardiqi, i cili më parashtrij pyetjen pse u është ndaluar transporti i nxënësve, arsyeja është se nuk kemi nëpunës të punësuar për transportin e fëmijëve, sepse kemi mungesë stafi mbështetës. Probleme të vogla ka pasur ku i kanë dëmtuar autobusët dhe duhet me shikuar ndonjë variantë tjetër, sepse nuk po mundemi me mbërri. Tani z. Artan Asllani e ka pasur një kërkesë me të cilën më është adresuar përmes e-mailit zyrtar, ku ka pasur një ankesë për lagjen ku jeton dhe në këtë kërkesë, e kemi dërguar tek KEDS-i, sepse është në kompetencën e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të falënderoj publikisht drejtor, për intervenimin në fshatin ‘Miradi të Epërme’, aty tek oda e të pamëve për zgjidhjen, të cilën na keni bërë, ku ka qenë kërkesë e imja për dhjetë vite.

Drejtori i Administratës: Dua t’i përgjigjem z. Artan Asllani, procedura për kurorëzim është nga dy deri në pesë ditë, në qoftë se është ndonjë rast individual dhe nuk i ka në rregull dokumentet, atëherë kjo donë shqyrtim.

Nënkryetari i Komunës: Do të mundohemi të gjitha pyetjet, të cilat janë parashtruar nga asambleistët, të ju japim përgjigje. Pyetja ishte nga znj. Dardane Sogojeva Shala, e cila pyeti, se a janë të përfshirë punëtorët e projektit të Karitasit në propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës. Ne nuk e dimë se kjo nuk është kërkesë e Ekzekutivit të Komunës, në rend dite ka ardhur nga sindikata, ata Kuvendit të Komunës i bënë kërkesë sindikatës dhe këtë kërkesë e kanë adresuar tek organi për t’ua kompensuar, ju e dini se nuk ka buxhet të aprovuar, që të paguhet shujtat nga buxheti i rregullt, sindikata e ka vazhduar procedurën tutje, ka pasur praktika të komunave tjera dhe raste të tjera, që janë realizuar, andaj ju ka drejtuar organit të komunës, ne e kemi procesuar menjëherë kërkesën e tyre dhe Kuvendi i Komunës duhet me miratuar si pikë e rendit të ditës, kështu se a janë të përfshirë punëtorët e projektit të Karitasit apo jo, e kemi përfaqësuesin e sindikatës që mund të japë shpjegime të më vonshme. E përmendi kompenzimin nga breshëri, po komisioni ka dalë në teren, e ka përgatit një draft të raportit, duhet të dorëzohet tek Ministria e Bujqësisë, aty ka mjete për këto kompenzime. Sa i përket dezinfektimit është në procedurë të prokurimit. Përgatitja për vitin shkollor ka qenë një pyetje, a kanë filluar me u bërë, po janë bërë katër lloje të përgatitjeve, identifikimi i normave të reja, ku shpallja e konkurseve është bërë dje, sa i përket normave të arsimit, e dyta ka qenë që të bëhet plani i shpërndarjes së nxënësve, ku kemi edhe një shkollë të re, ku presim me filluar me një shtator 2024 dhe do ketë ndryshime të lokacionit për disa nxënës, sepse do bëhet shpërndarja e nxënësve aktual, të gjithë drejtorët e shkollave së bashku me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, janë dakorduar që ta bëjnë një plan të shpërndarjes dhe drejtorët e shkollave e kanë marrë obligimin, për t’i lajmëruar prindërit në çdo rast kur ka ndryshim të lokacionit për fëmijët e tyre, në mënyrë që ata me qenë të njoftuar, tani unë nuk e di, sa kanë mundur ta bëjnë shpërndarjen e informatave për të gjithë. A ka kërkesë për banim social, ne nuk kemi bërë kërkesë për banim social, por ne kemi bërë një kërkesë, për të na ndihmuar qeveria për një qendër për kujdesin ndaj të moshuarve, sepse kemi shumë nevojë si komunë dhe ky ka qenë prioriteti i parë i joni, pastaj kemi pasur diskutime me Ministrinë e Shëndetësisë dhe ata kanë insistuar, që ne të financojmë Qendrën për kujdesin ndaj të moshuarve, ndërsa Ministria mund të financoj për ‘Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e financuar nga Ministria e Shëndetësisë, që do të ndërtohet në tri vitet e ardhshme në Komunën e Fushë-Kosovës, me objektin ekzistues jemi dakorduar me përfaqësuesit e Ministrisë, që të kemi Qendrën më të madhe të emergjencave si komunë, në mënyrë të ndarë me të gjitha shërbimet. Qendra e të moshuarve, na kanë refuzuar nga Ministria ndërsa na kanë kompensuar me ndërtimin e ‘Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare’ dhe ne jemi shumë të kënaqur.

Dardane Sogojeva Shala: Pjesa e kioskave të cilët po ju shesin fëmijëve, letra kush duhet me u përgjigj dhe kujt me ju drejtuar?

Aida Alimi: Raporti për punën e Këshillit të Sigurisë pse nuk vjen për shqyrtim dhe analizim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës?

Nënkryetari i Komunës: Sa i përket pyetjes së znj. Dardane Sogojeva Shala, nuk isha e qartë jo në pyetjen tënde, po në dhënien e përgjigjes dhe për ata e shënova, që të marrë informacione, sepse nuk e di në kompetence e kujt është, e para ka të bëjë me Inspektoratin e Tregut, që ka të bëjë për

këtë lloj produkti që shitet, e dyta, a është një mall i ndaluar, unë do interesohej me zyrtarin i cili është Inspektor i Tregut. Sa i përket pyetjes së z. Hasan Ismajli, ne e kemi një detyrë si komunë që të shkojmë dhe ta vendosim shenjë që ndalohet parking, pastaj të marrim masat tjera. Sa i përket Këshillit të Sigurisë, nuk e di pse nuk raporton, do të interesohej me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe në mbledhjen e radhës do të jetë në pikat e rendit të ditës. Për Xhaminë e vjetër në fshatin 'Miradi e Poshtme', nuk e di, e di që momentalisht janë duke u marrë me Kalanë e Harilaçit, ku shumë kompetenca janë të kufizuara nga ana e komunës, tek trashëgimia sepse jemi duke punuar me Ministrinë e Kulturës tek kjo pjesa e Harilaçit'. Sa i përket renovimit të shkollave, vetëm një shkollë është në renovim dhe nuk e dije tani a kanë filluar punimet. Në çerdhe ka filluar, sepse kam qenë dhe e kam vizituar vetë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pyetjet e parashtruara mbesin në ekstraktin e procesverbalit, Unë ju rikujtoj edhe një herë se punët e Kuvendit të Komunës dhe Ekzekutivit të Komunës, janë të ndara, pyetjet tuaj mbesin në procesverbal si shënime, përgjigjet nëse nuk i keni tani, mund t'i kërkonit që t'i merrni edhe me shkrim.

Koha e pushimit një kohëzgjatje prej një orë.

Pika e tretë (3) - Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e planit vjetor të punës në gjashtëmuajorin e parë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në këtë periudhë raportuese janë mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në vazhdim ne ua paraqesim shkurtimisht procesin e shqyrtimit të propozimeve dhe marrjen e vendimeve, me ndikim në realizimin e buxhetit të komunës dhe çështjeve tjera me rëndësi për komunën tonë, për periudhën në fjalë ua paraqesim me emërtim vendimet e marra gjithsej 26 vendime. Në vazhdim vlen të përmenden edhe disa sfida, që na kanë përcjell në këtë periudhë kohore, sikur është vazhdimi i mos publikimit të audio - incizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, vendosja e pikës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', në fund të rendit të ditës jashtë kornizës së planit të punës së miratuar në Kuvendin e Komunës, e cila ka shkaktuar një mos pajtim nga Grupet Parlamentare dhe lëshim të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, andaj ne kemi propozuar që vendim marrjen lidhur me këtë çështje, ta vendos prapë Kuvendi i Komunës, me kërkesën për ndryshimin-plotësimin e 'Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për periudhën maj/dhjetor 2024'. Po ashtu ka pasur disa herë mos marrëveshje, pengesa në punën e Kuvendit, lëshim të mbledhjeve, pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ka ndërprerë mbledhjet, varësisht prej rrethanave të krijuara nga veprimet politike të Grupeve Parlamentare në Kuvendin e Komunës. Ne si organ legjislativ kemi pasur edhe vështirësi lidhur me çështjen e përmendur më lartë, vendosjen në shqyrtim të pikave shtesë, por në Kuvendin e Komunës është lejuar zhvillimi nga ana ime, zhvillimi i debatit parlamentarë për secilin anëtarë të Kuvendit të Komunës, edhe te pyetjet dhe përgjigjet parlamentare, edhe te pikat tjera, para marrjes së vendimeve. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës, do të vazhdojmë të punojmë edhe në periudhën e ardhshme brenda këtij viti, njëherit kërkohet një korrektësi dhe qëndrueshmëri, ruajtje e gjuhës parlamentare nga të gjithë, brenda rregullave të Kuvendit të Komunës, nga secili Grup Parlamentarë, por edhe nga secili anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt - dokumentit për vlerësimin e rreziqeve natyrore dhe rreziqeve tjera për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë të 'Projekt - dokumentit për vlerësimin e rreziqeve natyrore dhe rreziqeve tjera për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', ftoi Udhëheqësin e Sektorit për Shërbime Publike, që të na jap sqarime.

Ejup Qyqalla - Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve Publike: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Të nderuar para vetes kemi një dokument me 134 faqe i cili, është i punuar dhe dizajnuar në formën më të mirë. Përmban 23 harta, 22 figura, mbi 30 tabela dhe 123 fusnota. Ky dokument nuk është përfunduar dhe për këtë arsye ka ardhur në Kuvendin e Komunës me qëllim që asamblistët t'i japin vlerësimet e tyre dhe te japin rekomandimet, që të plotësojmë sa më mirë në shqyrtimin e parë me vërejtjet dhe komentet e asamblistëve. Territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, sikurse edhe komunat e tjera, i atakojnë rreziqet e ndryshme, që mund të jenë, të natyrës, natyrore, teknologjike dhe të faktorit njeri. Situatat emergjente janë situata kur jeta normale e njeriut kalon në jetë jo normale, nga gjendja normale krijohet një gjendje jo normale ku hupet rendi juridik dhe kushtetues, varësisht prej përmasave katastrofave që e atakojnë atë territor, komunën tonë që i ka specifikat e veta, jemi një komunë që i ka 84 km katror, ku me territor jemi të vogël, e me shtim të numrit të popullsisë sipas statistikave të fundit kemi dyfishim të popullsisë. Vlerësimet e para sa i përket rreziqeve natyrore në komunën tonë janë: tërmetet, vullkanet erozionet, zjarret, vërshimet, orteqet, stuhitë pastaj kemi katastrofat teknologjike, te cilat e ndotin ajrin, ujin dhe tokën në mesin e tyre kemi 'KEK-un' shumë afër të cilët lirojnë gazna shumë të dëmshme. Biznese të dëmshme kemi edhe deponitë e derivateve në fshatin 'Miradi e Epërme', pastaj qumështoren në 'Miradi të Epërme', Biteksin në 'Vragoli. Po ashtu rritja e popullsisë gjeneron mbeturina shumë, të cilat ngërthejnë infeksione të ndryshme, nëse nuk menaxhohen mirë e te cilat e ndotin tokën dhe ujin. Kemi edhe ethet epidemiologjike. Rreziqet që ndikojnë nga faktori njeri janë rreziqet, lufta terrorizmi, çështjet sociale, zjarret individuale të cilat me vetëdije apo pa vetëdije i shkaktojnë ato, unë kisha mu ndal në komunën tonë, ku rreziqet më të mëdhaja janë: vërshimet që ndodhin për shkak se komuna jonë e ka pozitën më të ulët gjeografike në krahasim me komunat tjera. Në fshatrat 'Vragoli' dhe 'Kuzmin' është pika më e ulëta. Këtë dokument e kemi pas edhe në vitin 2013 i cili është rifreskuar me të dhëna të reja. Në këtë dokument bazë, ne e bëjmë vetëm vlerësimin e rreziqeve, ku na atakojnë vërshimet, zjarret. Pas këtij dokumenti duhet të hartohet edhe: 'Plani i reagimit të rasteve emergjente'. Unë kam një falënderim për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila na ka ndihmuar në këtë drejtim, pastaj Komandantin e Policisë z. Bekim Zogjani, Zyrtarët komunal, Kryqin e kuq. Ju kisha lutur çka do që keni mos hezitoni ta debatojmë t'i japim rekomandimet për përmirësimin e tij.

Vlonjat Hasani: Materialin e kemi marrë dhe me të vërtetë është shumë voluminoz si material, unë me sa pashë është më shumë si informacion, por këto informata janë të mira që të publikohen kush do që donë me pas njohuri me shumë rreth komunës. Ju thatë se kemi me nxjerrë dokumente tjera, unë pasi e kam lexuar materialin e kam shikuar çka paraqet edhe ligji dhe i kam parë disa gjëra që patjetër duhet me punuar në hartimin e dokumenteve tjera. Vlen ta përmendi nenin 12, te Ligjit për fatëkeqësi natyrore, ku thotë se organet qendrore dhe lokale detyrohen që ta njoftojnë popullatën e një zone të caktuar ku ka rrezik nga fatëkeqësitë natyrore dhe fatëkeqësitë tjera. Këtu me se shumti ne kemi problem me reshjet e mëdhaja të shiut, me vërshimet dhe e dimi ku i kemi vendet që janë më të prekura, atëherë duke u bazuar edhe në ligj, kishte qen mirë që ta bëjmë njoftime me tabela, pastaj njoftime publike ku i njoftojmë banoret e atyre zonave në mënyrë që ata me qenë të para përgatitur që të përballen me fatëkeqësi të ndryshme. Parimi i parandalimit, neni 14 i Ligjit për Fatëkeqësi Natyrore, thotë se organet lokale duhet të japin përparësi zbatimit te

masave për parandalimin e fatëkeqësive, atëherë kur ndahen fatëkeqësitë natyrore me sezone, duhet të ndërmarrim masa para. Ju si profesionist i fushës dhe hartues i këtij dokumenti kishte qenë mirë, që ashtu siç u akorduar dje, që të ketë edhe anëtar të Kuvendit në hartim dhe dëgjime publike për lexim të dytë, ne jemi për me kontribuar dhe me ndihmuar në këtë pikë, po ashtu e përkrahim si pikë e rendit të ditës për miratim në parim.

Laureat Gojnovci: Ky dokument është shumë mirë i përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, e qe është dokument bazë për nxjerrjen e dokumenteve tjera në të ardhmen. Unë në emër të anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga Grupi të Lidhjes Demokratike të Kosovës, falënderoj të gjithë ata që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti, i cili besoj që mundet me qenë edhe si model për komunat e tjera për vlerësimin e rreziqeve.

Mirsad Qyqalla: Unë ju inkurajoj për punën është një dokument voluminoz, ne në Komitetin për Politikë dhe Financa, i kemi dhënë disa rekomandime ku besoj se ka me i përfshirë në dokument, besoj se është shumë e nevojshme, keni kontributin dhe mbështetjen tonë në çdo kohë.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Unë e përkrah dhe e mbështesë këtë iniciativë, sepse është shumë e nevojshme, sepse para disa dite, ne patëm në lagje rastin të përballimi me një fatëkeqësi natyrore dhe nuk patëm mundësi me ju ndihmuar. Ku disa familje kanë mbet pa kullm mbi kokë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim ‘Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt - dokumentit për vlerësimin e rreziqeve natyrore dhe rreziqeve tjera për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi në parim për diskutim publik ‘Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt - dokumentit për vlerësimin e rreziqeve natyrore dhe rreziqeve tjera për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe procedimin e saj për diskutim publik.
2. Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e vlerësimit dhe evidentimit të lokacioneve dhe vendeve me rreziqe në territorin e komunës.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i kërkesës me Nr. 02-070/05-0021913/24 për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Kërkesës për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës’, kjo praktikë është ndjekur edhe në disa komuna tjera të vendit tonë. Ftoi përfaqësuesin e Sindikatës së Administratës Komunale që të na jap sqarime.

Abaz Xhigoli - Drejtori i Qendrës për Punë Sociale: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në emër të Sindikatës së punëtorëve të administratës komunale, ne kemi shqyrtuar kërkesën për mbulimin e shpenzimeve për shujta për punëtorët e sindikatës në Fushë-Kosovë, për arsye se shumica e punëtorëve posedojnë paga të ulëta dhe duke e pasur parasysh rritjen e çmimeve,

inflacionin, situatën ekonomike dhe rritjen e kostos financiare të jetesës për mirëqenien e familjeve, që dukshëm reflekton në jetën e tyre, konsiderojmë që kjo sindikatë për vitin 2023/2024 të parasheh ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej: 4.00€ për një ditë pune. Këtë e kanë praktikuar edhe disa komunat të tjera, për pagimin e shujtave për stafin edhe ne si sindikatë besojmë fuqishëm se do të na aprovoni kërkesën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë pyes sa punëtor janë ? sa është shuma ? dhe si keni ardhur deri tek shuma prej: 4.00€, si dhe bazën ligjore në të cilën jeni mbështet.

Abaz Xhigoli - Drejtori i Qendrës për Punë Sociale: Kostoja vjetore për vitin 2023 dhe 2024 është në shumën e mjeteve financiare prej: 319,000.00€, ku shujta do të jetë nga 4.00€ për vitin 2023 retroaktivë dhe vitin 2024, si baza ligjore mendoj që pjesë e pagës është edhe shujta. Kjo nuk aplikohet për herë të parë. Punëtorët e arsimit e kanë realizuar këtë.

Laureat Gojnovci: Ne Lidhja Demokratike e Kosovës jemi për këtë propozim, ne kemi kërkuar disa sqarime, ku sot përfaqësuesi i sindikatës së administratës komunale na dha, baza ligjore rrjedh në bazë të kontratës kolektive të ndërprerë në vitin 2021, ne duke parë gjendjen e rëndë ekonomike në vendin tonë dhe shumë zyrtarë të komunës, kanë paga shumë të ulëta. Këta zyrtar kryejnë shërbime për 64 mijë banorë. Ne e përkrahim meqenëse kjo punë po praktikohet, edhe në komunat tjera.

Durim Hajra: Në parim ne Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosjen nuk jemi kundër ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës. Mirëpo ne duhet me pas të qartë se çfarë vendimi duhet me marr Kuvendi dhe janë disa dilema që duhet me najë dhënë parashtruesi i kërkesës, e para dokumentin që e kemi këtu organit që i është drejtuar Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, thotë që është sindikata e administratës së komunës së Fushë-Kosovës, në një hulumtim në Ministrinë e Financave unë nuk gjeta një sindikatë të tillë, ndoshta është edhe mungesë e përditësimit të dhënave, por e kemi obligim para marrjes së një vendimi mi sqarua çështjet që si kemi të qarta. A kanë mu përfshijë të gjithë punëtorët e administratës komunale të Fushë-Kosovës ? Sa punëtorë janë, që nuk e vijnë procesin e punës e paguhen, a do të përfshihen këta nëse veç mirret si vendim. Ne nuk e dimë se a kemi të drejtë që ta marrim këtë vendim? A keni biseduar edhe me Drejtorin e Financave dhe Buxhetit se si kanë mu realizuar këto pagesa? Drejtorja e Financave dhe Buxhetit e ka si informatë, që kategoria për paga dhe mëditje në nivel të vendit është afro 35 milion euro në minus, e për ata them se nuk e besoj që Ministria e Financave me mbështet një kërkesë në formën që ka ardhur, ne po japim edhe një propozim që me ua dëshmuar që jemi me ju mbështet, që t'i drejtoheni fillimisht Drejtorisë së Financave, që ata ta gjejnë formën prej kategorisë së investime kapitale, të dërgojnë kërkesën ashtu siç duhet në Ministrinë e Financave për mu lejuar mjetet, në mënyrë që me ardhur deri tek ajo të cilën, po e kërkoni, në këtë formë drejtor vetëm mundemi me diskutuar, sepse adresa për Kuvendin e Komunës nuk është, ne sot do të abstenojmë.

Mirsad Qyqalla: Ne edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa biseduam për këtë pikë, por edhe ne si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës i patëm disa dilema. Këtu është dashur që edhe Drejtori i Administratës me na siguruar të dhënat që ne si kemi. Këtu kemi edhe punëtorët me Projektin e Karitasit, që punojnë me vite, e pyetja legjitime çka për këta punëtorë? Nëse kjo shpërndahet në mënyrë të barabartë atëherë, unë mendoj se edhe këta janë punëtorë, edhe pse nuk janë me kontratë të përhershme, prandaj duke i parë këto dilema dhe pa qartësi kjo po shihet se ka me kaluar përmes një përmbartuesi për t'i tërhequr mjetet financiare, në kërkesë nuk po thotë se komuna u'a ka borxh si në kontratën e arsimit. Prandaj unë them se përgatitja e kësaj kërkesë është shumë e dobët, pa informata shtesë. Unë mendoj se është dashur me pritë buxhetin e ardhshëm mu

diskutuar. Ka punëtorë që nuk vijnë kurrë në punë dhe nëse ne votojmë për këto shujta, ata kanë me qenë përfitues dhe kjo është pabarazi dhe për këtë arsye s'jam pjesë e votimit, se nuk dua që dikush të jetë i privilegjuar, e dikush jo, sepse ka shumë që punojnë e nuk gëzojnë këtë të drejtë, unë do ta zgjedh abstenimin sa i përket kësaj pike të rendit të ditës.

Hasan Ismaili: Unë po filloj, që kanë nevojë punëtorët e administratës me pasur pagesën e shujtave në vlerë prej: 4.00€ është normale, ndërsa që kjo kërkesë ka ardhur në emër të sindikatës, e që nuk është e regjistruar si sindikatë është e vërtetë, unë e votoj sepse të gjithë e dimë se çfarë pune bëjnë zyrtarët e administratës, sidomos sektorët e veçantë të cilët kanë koeficient shumë të ulët, por unë dua t'i eliminoj disa dilema që i kam, unë kërkoj një përgjigje nga Drejtori i Administratës, sepse ju e dhatë një shifër sa është kostoja e këtyre të ardhurave për vitin 2023, ndërsa nuk mundeni me dhënë për vitin 2024, sepse ende nuk ka kaluar dhe këtu nuk mundet mu llogarit, as pushimi mjekësor dhe as pushimi vjetor, sepse nuk e din kush ka me shkuar në pushim mjekësorë, po ashtu ka shumë që nuk e shfrytëzojnë komplet pushimin këtë vitë, sepse kanë të drejtë ta shpenzojnë në vitin që vjen dhe për këtë arsye, ju nuk mundeni me dal me shifra të sakta. Ky Kuvend ka pruar shumë vendime të cilat nuk janë zbatuar kurrë, sa do të u'zbatojnë këtë nuk e di dhe sa e keni ju guximin me protestuar për me ardhur, deri tek realizimi i kërkesës suaj është problem i juaji. Sa i përket Projektit të Karitasit, ligjërisht nuk ju takon por është problem tjetër tek punëtorët të cilët kanë punuar me vite, disa punëtorë tjerë nuk vinë në punë dhe nëse ata e merr rrogën nuk mundesh me ja ndalë shujtën, sepse ata e marrin me gjykatë. Ju keni dhënë leje mos me ardhur me vite në punë dhe me marrë rrogë barabartë me këta që punojnë, me të vërtetë s'po kuptoj fare, unë Drejtorit të Administratës ju kam drejtuar me pyetje, mirëpo më ka thënë që nuk është në domenin tim. Unë jam kundër edhe shujtave tek drejtorët, sepse i kanë pagat e mira, kanë beneficione, shëtitën me makinë ku ata dëshirojnë, ndërsa punëtorët shkojnë këmbë, unë në listën që e kam përpara në kohën e Covidit janë paguar 45 persona dhe shuma totale është afër 24,300.00€, të cilat nuk kanë qenë të parapara me buxhet dhe këta i kanë marrë për vete, pasi që këta kanë marrë, e në mesin e tyre është edhe Ish/Nënkryetari i Komunës dhe disa drejtorë unë nuk mundem mos me votuar këtë pike të rendit të ditës, që është pikërisht për punëtorët të cilët çdo ditë i shërbejnë qytetarëve.

Dardane Sogojeva Shala: Nuk jam për mos me votuar, por duke përfshirë edhe punëtorët e Projektit të Karitasit, të cilët për dhjetë vite punojnë dhe kontribuojnë në komunë, me u përfshirë komplet.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Kërkesën me Nr. 02-070/05-0021913/24 për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e tre pjesëmarrës në votim, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Kërkesën me Nr. 02-070/05-0021913/24 për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve të shujtave për punëtorët - zyrtarët publik të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0021913/24, të datës 17.08.2024, për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës.

2. Shuma e mjeteve financiare të ndara sipas pikës një të këtij vendimi, është 4.00 € në ditë, për secilin nëpunës të shërbimit civil të Administratës Komunale, e siguruar nga kategoria e 'Paga dhe shtesa'.
3. Qëllimi i këtij vendimi është realizimi i shujtave ditore, në vlerë prej 4.00 € në ditë, në mënyrë retroaktive, për vitin 2023 dhe për vitin 2024 për të gjithë nëpunësit e shërbimit civil të Administratës Komunale në Fushë-Kosovë.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021'. Hap diskutimin.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Duke pasur parasysh që në Komitetit për Komunitete nuk është i përfshirë një anëtar nga Komuniteti Egjiptian, kërkoj që të emërohet një anëtar, për arsye se anëtarja që ka qenë, nuk merr pjesë në mbledhjet e Komitetit për Komunitet edhe pas bisedës telefonike, që e kemi bërë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021' dhe mori:

V E N D I M


1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7, të vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Komunitetit Egjiptian, duke e larguar znj. Linda Hyseni nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e z. Bashkim Kransiqi në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për tu avansuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komuniteteve brenda Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta marrin fjalën nëse e kanë ndonjë çështje për diskutim. Ju njoftoj se zyrtarisht jemi në pushim deri më datë 25.08.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 15:15 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

